



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 643 Akti

Nr. 742 Vendimi  
Tiranë, më 13.3.2024

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesuese
<b>Alma Faskaj</b>	Relatore
<b>Pamela Qirko</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 11.3.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Hektor Sinanaj**, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- 1.** Subjekti i rivlerësimit, z. Hektor Sinanaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
- 2.** Në përfundim të shortit rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Hektor Sinanaj, do të shqyrtohet nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj relatores, Xhensila Pine kryesuese dhe Pamela Qirko anëtare.
- 3.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
- 4.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (sot Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.
- 5.** Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Hektor Sinanaj (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2023, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Hektor Sinanaj.
- 6.** Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.
- 7.** Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuese e trupit gjykues komisionerja Xhensila Pine. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

**8.** Në datën 7.2.2024, trupi gjykues me vendimin nr. 2 vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Hektor Sinanaj, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

**9.** Në datën 7.2.2024, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, duke i kaluar barrën e provës për sa ka rezultuar nga hetimi dhe duke i dhënë të drejtën të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë shpjegime/prova shtesë brenda datës 16.2.2024.

**10.** Në datën 11.2.2024, subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrje të afatit të paraqitjes së provave me 10 ditë, pas datës 16.2.2024, për arsye se deri në datën 13.2.2024 ishte me raport mjekësor për paaftësi në punë. Trupi gjykues, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, pranoi kërkesën e subjektit duke zgatur afatin e dërgimit të parashtrimeve deri në datën 1.3.2024.

**11.** Në datën 12.2.2024, subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes.

**12.** Në datën 23.2.2024, subjekti i rivlerësimit dërgoi në rrugë elektronike (me *email*) shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të shoqëruara me dokumentacion.

**13.** Në datën 6.3.2024, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Hektor Sinanaj, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike e njoftoi se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 11.3.2024, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

**14.** Në datën 7.3.2024, subjekti i rivlerësimit dërgoi në rrugë elektronike (me *email*) kërkesë për shtyrje të seancës dëgjimore për shkak të njoftimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor se në datën 13.3.2024, ora 11:00, ishte caktuar zhvillimi i seancës dëgjimore për fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij.

**15.** Në datën 7.3.2024, Komisioni nëpërmjet rrugës elektronike njoftoi subjektin e rivlerësimit se kërkesa e tij drejtuar trupit gjykues për të caktuar një datë tjetër për seancën dëgjimore nuk ishte pranuar.

**16.** Në datën 11.3.2024 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

**17.** Në datën 11.3.2024, subjekti i rivlerësimit kërkoi përjashtimin e trupit gjykues, duke argumentuar se ky trup ka kryer disa shkelje të rënda procedurale ndaj procesit, të cilat janë:

- *Nuk u është përgjigjur kërkesave të subjektit ndaj pretendimeve për procesin, si kërkesa për pezullimin e procedurës administrative deri në përfundimin e procesit gjyqësor të Gjykatës Administrative për konfirmimin e dokumenteve të Bankës Shtetërore për pagesën e tatimeve të subjektit të avokatisë në vitet 1992 – 1997.*
- *Nuk ka vlerësuar provat e reja të paraqitura prej subjektit në këtë proces, madje ka vendosur barrën e provës në mënyrë të paarsyeshme për të dhëna të cilat janë dokumentuar që prej vitit 1992.*
- *Është njoftuar në një afat shumë të shkurtër, duke i lënë një afat shumë të shkurtër përgatitjeje prej 3 ditësh në caktimin e seancës dëgjimore.*

- Nuk është pranuar kërkesa për shtyrjen e datës, për shkak se në datën 13.3.2024 do të zhvillohej seancë dëgjimore në KLGJ.
- Mungesa e garancive ligjore të sipërcituara e bën vendimin në shkelje të procesit të rregullt ligjor, në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

**18.** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.3.2024, Komisioni vendosi ngritjen e trupit gjykues që mori në shqyrtim kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues.

**19.** Trupi gjykues, me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2024, vendosi mospranimin e kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues, duke arsyetuar se:

- *...Për asnjë rast ushtrimi i detyrës funksionale dhe/ose mënyra e interpretimit dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi nuk përbën paragjykim dhe cenim të paanësisë së trupit gjykues dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përbëjë shkak për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues.*
- *Parimet e paanësisë dhe objektivitetit në gjykim, të parashikuara në nenet 6 dhe 39 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nenin 42 të Kushtetutës, nuk janë cenuar në rastin konkret nga trupi gjykues.*
- *Subjekti në kërkesën e tij nuk ka parashtruar shkaqe dhe rrethana konkrete referuar dispozitës së cituar prej tij, neni 30, paragrafi “g” i Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohen rastet e dorëheqjeve të organit vendimmarrës, duke u shprehur se anëtarët e trupit gjykues ose personat e përmendur në shkronjën “b” të këtij neni kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim.*

**20.** Në datën 13.3.2024, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, shpalli vendimin për subjektin e rivlerësimit, z. Hektor Sinanaj.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**21.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Hektor Sinanaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

**22.** Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit, z. Hektor Sinanaj, shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

**23.** Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**24.** Z. Hektor Sinanaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur dhe duke dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, konform nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

25. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

26. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

27. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

28. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

29. Në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

30. Por, referuar vendimit nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

31. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e subjektit dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

32. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Hektor Sinanaj, i cili është bërë subjekt deklarues në këtë institucion në vitin 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të

ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

**33.** Subjekti i rivlerësimit, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* (duke përfshirë personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur) në datën 27.1.2017, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

**34.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

## **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**35.** Pas depozitimit të raportit nga ILDKPKI-ja, Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të këtij institucioni, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesit.

## **Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur**

**36. Godinë 3-katëshe (kati i parë me destinacion zyra dhe 2 kate banimi),** me nr. pasurie \*\*\* e \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, ndërtuar nga fundi i vitit 1992, rikonstruktuar me lejet e ndërtimit nr. \*\*\*, datë 13.7.2001 dhe nr. \*\*\* datë 15.5.2001, sheshit të ndërtimit dhënë nga KRRT Bashkia Vlorë, me destinacion banesë 2 kate plus zyra në katin e parë. Regjistruar si karabina në ZVRPP-në Vlorë me nr. \*\*\*, datë 29.10.2004, z. k. \*\*\*, vazhduar punimet deri në mars të vitit 2006, ndërprerë për shkak të përfundimit të afatit të lejes, mbetur pa u përfunduar çatia sipas projektit. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Nga viti 1993 ambientet e godinës, fillimisht me firmën e ndërtimit “R.K”, me të cilën kam lidhur kontratën datë 20.5.1993, kemi përshtatur ambientet e katit përdhe si zyrë avokatie e më pas bar-bilardo, plus zyrë avokatie. Pas marrjes së lejes së rikonstruksionit, në katin e parë (mbi katin përdhe) nga kursimet familjare, si dhe me kredi bankare nga BKT-ja, kam përshtatur gjithsej 9 zyra, të cilat i ka dhënë me qira bashkëshortja me kontrata të rregullta me qiramarrësit. Më pas, kati përdhe është përshtatur si kopsht fëmijësh në administrim nga bashkëshortja me NIPT \*\*\*. Vlera gjithsej sipas situacionit pas rikonstruksionit, në shumën 9,194,890 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: kursimet familjare, të ardhurat nga puna si avokat, pagat si përmbarues, sekretar, gjyqtar. Të ardhurat nga kopshti privat, dhënia me qira e zyrave, të ardhurat nga*

depozita bankare në BKSH, BKT, Raiffeisen Bank, Credit Agricole (ish-Emporiki Bank). Kredi bankare në shumën 20,000 USD në BKT, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.4.2005, kontratë hipoteke pas. nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*. Kontratë huadhënieje me interes 6% në muaj, në shumën 1,000,000 lekë, sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 10.5.1996, huadhënës biznesmeni A.M. Pagesat e qirave janë bërë edhe në euro. Gjatë punës si avokat kanë bërë edhe shkëmbim valute, nga ku kam nxjerrë përfitime në të ardhura në treg të lirë. Pasi u hoq dënimi me vdekje dhe u rritën pagat e gjyqtarëve, si dhe kisha të ardhura nga biznesi, bar-bilardo, kopsht e zyra me qira, kalova gjyqtar më 6.3.2000”.

## **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**37.1** Nga verifikimi i deklaratave të pasurisë në ILDKPKI rezulton se kjo pasuri është deklaruar nga subjekti nga viti 2003 deri në vitin 2006 për ndryshime, shtesa, bashkime dhe shpenzime në vite, si dhe përfitime të ardhurash nga qiratë. Nga viti 2006 e në vazhdim nuk është deklaruar më asnjë ndryshim deri në deklaratën *Vetting*, përveç përfitimeve të të ardhurave nga qiratë.

**37.2** Sipas deklarimeve të subjektit, kjo pasuri ka filluar të ndërtohet në vitin 1992 pa një leje ndërtimi në oborrin e shtetasit A.D, i cili nuk e kishte të regjistruar në emër të tij. Më vonë subjekti deklaroi se është pajisur me leje në datën 6.6.1993 pranë Bashkisë Vlorë, fillimisht për ndërtimin e një zyre avokatie, por nga dokumentacioni i depozituar për procesin e rivlerësimit nuk rezulton të jetë bashkëlidhur kopje e lejes së ndërtimit, për të cilin ka paraqitur vetëm një fotokopje mandatarkëtimi në Bankën e Shtetit nr. \*\*\*, datë 22.4.1993 “Pagesë për leje ndërtimi” për Këshillin e Rrethit Vlorë.

**37.3** Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi gjatë gjykimit të ndonjë çështjeje gjyqësore të çfarëdolloji, qoftë ajo nga subjekti Hektor Sinanaj, ku palë në gjykim të ketë qenë shtetasi A.D (në oborrin e të cilit subjekti ka ndërtuar objektin sa sipër). Për këtë iu drejtua Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, e cila me përgjigjen e saj<sup>1</sup> konfirmon se gjatë kohës së ushtrimit të detyrës, për periudhën 2000 e në vijim rezulton se subjekti Hektor Sinani/Sinanaj nuk ka gjykuar çështje gjyqësore të çfarëdolloj cilësie, ku palë ndërgjyqëse të ketë qenë shtetasi A.D.

**37.4** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.11.1993, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur: “*Të njoh pronar kërkuar Hektor Sinani mbi një zyrë avokatie në lagjen “\*\*\*”, pranë K, me përmasa (6x6) m, ndërtuar me mur blloku, mbuluar me soletë, mbi një shesh me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>...*”. Ky vendim ka gjetur pasqyrim edhe në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive Vlorë.

**37.5** Në deklaratimet e tij, subjekti shprehet se me ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile, duke qenë se vërtetimet e fakteve juridike nuk regjistroheshin në hipotekë ose ato që ishin regjistruar para vitit 1994 ishin thjesht me cilësinë e provës, ka paraqitur kërkesëpadi në gjykatë për njohje pronar, me palë të paditur Bashkinë Vlorë. Kështu, me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.3.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur: “Pranimi i kërkesëpadisë. Detyrimi i palës së paditur Bashkia Vlorë të njohë pronar Hektor Sinanin mbi një godinë njëkatëshe (zyrë avokatie) të ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Vlorë, e ndërtuar me mur blloku mbuluar me soletë, e përbërë prej një dhomë, aneks, banjë, garazh, me sipërfaqe trualli 150 m<sup>2</sup>, e rrethuar me mur.

---

<sup>1</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2023.

**37.6** Me vërtetimin hipotekor<sup>2</sup> datë 5.4.1996, lëshuar nga Hipoteka Vlorë, vërtetohet se pas marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor sa më sipër, në emër të qytetarit Hektor Sinani figuron e regjistruar pasuria godinë njëkatëshe e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, e ndërtuar me mur blloku, mbuluar me soletë, e përbërë nga një dhomë, aneks, banjë, garazh, me sipërfaqe trualli 150 m<sup>2</sup>.

**37.7** Në vitin 2001, me vendimin e KRRT-së nr. \*\*\*, datë 15.5.2001 “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane”, është vendosur që investitorit Hektor Sinani t’i miratohet sheshi i ndërtimit banesë<sup>3</sup> 2 kate + zyra në katin e parë në lagjen “\*\*\*\*”. Në vijim është miratuar edhe leja e ndërtimit për projekt zbatim objekti, miratuar për sheshin e ndërtimit me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.5.2001, të KRRT Vlorë.

**37.8** Në vitin 2002, subjekti Hektor Sinani dhe Bashkia Vlorë, si dhe personi i tretë KKKPronave Qarku Vlorë, janë paditur në gjykatë nga shtetasit A dhe T.D, me padi “1. Kundërshtim i vendimit nr. \*\*\*, datë 13.9.1999 të KKKPronave..., Kundërshtim të vendimit nr. \*\*\*, datë 13.7.2001, të Këshillit të Rregullimit të Territorit pranë Bashkisë Tiranë...”. Në përfundim, kjo gjykatë me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.10.2002, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë së paditësve D në lidhje me kthimin dhe kompensimin e disa metra sipërfaqe të ndodhur në qytetin e Vlorës dhe rrëzimin e padisë për pjesën ndaj të paditurit Hektor Sinani, si të pabazuar në prova e në ligj. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. \*\*\*, datën 25.2.2003 dhe Gjykata e Lartë me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.5.2004, ka vendosur: “Mospranim rekursi të paraqitur nga shtetasit TH.D e A.D”<sup>4</sup>.

**37.9** Në vitin 2004, nga Bashkia Vlorë është mbajtur akt kontrolli datë 21.10.2004, për realizimin e punimeve ndërtimore dhe përfundimin e karabinasë për të gjithë objektin dhe në datën 29.10.2004, sipas certifikatës për regjistrimin e karabinasë, vërtetohet se në regjistrin provizor të karabinasë nr. \*\*\*, datë 29.10.2004<sup>5</sup>, figuron e regjistruar<sup>6</sup> në pronësi të subjektit ndërtues “B” sh.p.k., me investitor Hektor Sinani, pasuria e ndodhur në z. k. \*\*\*, me sipërfaqe 130 m<sup>2</sup>, në adresën lagjja “\*\*\*\*”, Vlorë, karabina e objektit banesa dy kate + zyra në katin e parë, me sipërfaqe ndërtimi 130 m<sup>2</sup>.

**37.10** Në vitin 2015, shtetasi TH.B, kufitar me subjektin në lindje të kjo godinë, i është drejtuar organit të Prokurorisë duke kallëzuar për ndjekje penale shtetasin Hektor Sinanaj, për mënyrën e fitimit dhe regjistrimit të zyrës ku punonte më parë shtetasi Hektor Sinani, për mënyrën e regjistrimit në ZVRPP (në lidhje me kufitarët), si dhe për pronësinë e truallit mbi të cilën ky i fundit ka ndërtuar zyrën e më tej godinën trekatëshe. Ky shtetas e akuzon subjektin për

---

<sup>2</sup> Kopje e vërtetimit nga dokumentet hipotekore, lëshuar në datën 20.1.2000, ku vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 5.4.1996, figuron e regjistruar në pronësi të z. Hektor Sinani pasuria me nr. \*\*\* e \*\*\*, e ndodhur në z. k. \*\*\*, me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, godinë njëkatëshe me konstruksion mur blloku e mbuluar me soletë, e përbërë nga një dhomë, aneks, banjë e garazh. Kufizuar V-K. Vlorë, J-Dyqani A. D., L-Dyqani A. D. J. dhe Th. B., P-V. H. ASHK Vlorë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2023, konfirmon nga arkivi regjistrimin në vitin 1996 të godinës njëkatëshe në lagjen “\*\*\*\*”, me konstruksion mur blloku, e mbuluar me soletë, e përbërë nga dhomë, aneks, banjë dhe garazh, me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, e rrethuar me mur.

<sup>3</sup> Sipërfaqe e sheshit 206 m<sup>2</sup>. Sipërfaqe ndërtimi 130 m<sup>2</sup>. Numri i kateve tre, numri maksimal i kateve tre, koeficienti i shfrytëzimit të territorit 63%. Numri i kateve mbi tokë tre.

<sup>4</sup> Kopje e vendimeve gjyqësore bashkëlidhur deklarimit në pyetësorin nr. 2.

<sup>5</sup> Certifikatë provizore për regjistrimin e karabinasë nr. \*\*\*, datë 29.10.2004 dhe hartë treguese, e lëshuar nga ZVRPP Vlorë, ku konfirmohet pasuria me sip. 130 m<sup>2</sup>, me përshkrimin “Karabina e objektit banesa 2 kate + zyra në katin e parë me sipërfaqe ndërtimi 130 m<sup>2</sup>, e ndodhur në z. k. \*\*\*, subjekti ndërtues “B”, me investitor shtetasin Hektor Sinani”.

<sup>6</sup> Certifikata është lëshuar në datën 21.3.2005.



falsifikim të kufitarëve të pronës së tij. Gjithashtu, ai e kallëzon edhe për ushtrim të aktivitetit privat rreth 6 zyra, të cilat pronari ia ka dhënë me qira rreth 10 personave fizikë dhe nuk i ka lejuar të vendosin tabela, me qëllim mosidentifikimin nga organet kompetente. Në përfundim të këtij hetimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.5.2015, ka vendosur pushimin e çështjes penale, me arsyetimin se në rastin konkret nuk rezulton se ndodhemi përpara konsumimit të figurës së veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, apo përpara ndonjë vepre tjetër penale, pasi fakti objekt kallëzimi nuk ekziston.

**37.11** Kjo çështje ka shkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.9.2015, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit TH.B, me objekt kundërshtim të vendimit të prokurorisë për “Pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*, datë 25.5.2015”, si të pabazuar në ligj e në prova”. Më tej, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.6.2017, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 29.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier” dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.10.2022, ka vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga ankuesi TH.B”.

**37.12** Subjekti është pyetur nga Komisioni dhe ka dhënë shpjegime mbi mënyrën e përfitimit të truallit mbi të cilin është bërë ndërtimi i objektit sa sipër. Në shpjegimet e tij, subjekti në mënyrë të përmbledhur<sup>7</sup> ka shpjeguar se: “...me daljen e ligjit nr. 7512/1992 u privatizua shërbimi i avokatisë. ...Në vendin ku unë planifikova të ndërtoja zyrën time, fillimisht bisedova me personin që posedonte një magazinë e dyqan privat A.D (i njohur prej meje gjatë kohës që isha sekretar e përmbartues në gjykatë), i cili më paraqiti edhe dokumentin e pronësisë së tij, ku kishte rrethuar edhe ambientin funksional – oborr. Ramë dakord që të vinte në dispozicion pjesën veriore që e kishte në posedim dhe të ndërtoja në pjesën funksionale (në pjesën veriore). Menjëherë fillova ndërtimin në fund të vitit 1992 (sapo kisha ardhur nga emigracioni), duke piktuar vendin dhe blerë e vendosur materialet, brenda ambientit të oborrit, që u vendosa me mirëkuptimin e personit, që rezultoi se e kishte vetëm në posedim, pa e regjistruar de jure. Ndërkohë, i drejtova kërkesë Bashkisë, e cila miratoi sheshin e ndërtimit e lejen për zyrë avokatie, datë 6.6.1993, aty ku fillova ndërtimin (mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 22.4.1993, pagesa për Këshillin e Rrethit Vlorë në BKT Vlorë). ...Unë, duke e pasur objektin në pronësinë time zyrën, e konfirmova këtë fakt pronësie me vendimin gjyqësor nr. \*\*\* vendimi, datë 16.11.1993, sipas nenit 155 të Kodit të Procedurës Civile (ligji i kohës), vendim të cilin e regjistrova në hipotekë. ...me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.3.1996, të Gjykatës së Rrethit Vlorë, me palë të paditur Bashkia Vlorë, më është njohur pronësia... Me vendimet nr. \*\*\*, datë 15.5.2001, të sheshit të ndërtimit dhe lejes së ndërtimit nr. \*\*\*, datë 13.7.2001, të KRRT Bashkisë Vlorë, u miratua ndërtimi “Banesë 2 kate + zyra në katin e parë”. ...Pas regjistrimit, në përfundim të ndërtimit të karabinasë të godinës në ish-ZVRPP, me nr. regjistri 29.10.2004, proceduar sipas ligjit (duke paraqitur akt kontroll-verifikimi përfundim punimesh, lejen e sheshit të ndërtimit) për regjistrim nga vetë Bashkia Vlorë (KRRT), kam vënë në funksionim në ambientet e katit të dytë të godinës trikatëshe dhe të katit të parë zyra me qira dhe në sipërfaqen më të madhe, duke pas administrimin si bashkëpronare bashkëshortja L.S... 2007 – 2008 me licencë profesionale kopshti privat. Duke qenë se nuk u arrit ndërtimi i papafingos mbi katin e sipërm dhe nuk u arrit të merrej tashmë akti i kolaudimit përfundimtar për t’u përcjellë në ASHK, godina ka funksionuar falë regjistrimit me certifikatë provizore të pronësisë (karabina),

<sup>7</sup> Përgjigje nga pyetësi nr. 2.

*që sipas ligjit lejohet funksionimi për dhënie me qira të ambienteve të përfunduara, deri në marrjen e aktit të kolaudimit, para përfundimit të punimeve e pajisjen me akt kolaudimi e funksionimi përfundimtar nga Bashkia, për ta dërguar në ASHK. Duke pritur të prishen edhe dy ndërtime afër godinës time të palegalizuara, do të rifreskoja lejen e ndërtimit edhe për papafingon, gjë që tashmë me daljen e ligjit nr. 20/2020, ku për ndërtimet me leje pas vitit 1991 regjistrohet pronësia në fazën e punimeve, që janë kryer dhe më pas të përfundoj plotësisht ndërtimin sipas projektit të rifreskimit të lejes për papafingon (çatinë)”.*

**37.13** Nga fotot që subjekti ka përcjellë në Komision<sup>8</sup> evidentohet që objekti është funksional.

**37.14** ASHK Vlorë<sup>9</sup> konfirmon regjistrimin e objektit karabina me sipërfaqe sheshi 206 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 130 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë (z. k. \*\*\*, vendimi i KRRT-së, leje legalizimi, shesh ndërtimi, akt piketimi, akt kontrolli punimesh). Regjistruar në datën 20.10.2004.

**37.15** Ujësjiellës Kanalizimet Vlorë<sup>10</sup> konfirmon se shtetasja L.S (bashkëshortja e subjektit) është e regjistruar si klient privat.

**37.16** Gjatë hetimit rezultoi se subjekti kishte mospërputhje në deklaratimet e tij në vite në deklaratat periodike vjetore në ILDKPKI, mbi sipërfaqen e truallit mbi të cilin është ndërtuar kjo pasuri. Në lidhje me këtë konstatim subjekti<sup>11</sup>, ndër të tjera, shpjegon se: *“...Mospërputhjet e vogla në sipërfaqet e truallit janë bërë në aplikim nga hartografët në regjistrimin fillestar të përkohshëm. Pas regjistrimit përfundimtar, që do të aplikohet në përfundim të punimeve, ku ka ngelur pa ndërtuar papafingoja, për të cilën pas pengesave nga mosmarrëveshjet në gjykime, janë tashmë përfunduar nga të tria instancat gjyqësore, ku në vendimet e tyre pasqyrohet ligjshmëria e pronësisë sime. Sipërfaqja ndërtimore e objektit është ajo e miratuar me lejen e ndërtimit 130 m<sup>2</sup>. Ndërtesa 130 m<sup>2</sup> është bashkëngjitur me ndërtesën 60 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, kati i parë dhe i dytë, duke u shtuar edhe trualli distancë ndërmjet tyre, rreth 20 m<sup>2</sup>. Me regjistrimin përfundimtar do të saktësohen edhe sipërfaqja edhe kufijtë e saktë aktualë...”*

**37.17** Gjatë të gjitha deklaratimeve të tij, subjekti ka deklaruar për rikonstrukcion të godinës me lejen e ndërtimit nr. \*\*\*, datë 13.7.2001 dhe nr. \*\*\*, datë 15.5.2001, kur në asnjë pikë të vendimit të KRRT-së për miratimin dhe as në aktin e lejes së ndërtimit të vitit 2001 nuk flitet për rikonstrukcion, por ky akt flet për ndërtim të ri mbi një shesh me sip. 206 m<sup>2</sup>. Për këtë subjektit i është kërkuar të japë shpjegime të shoqëruara me dokumentacion ligjor për pasurinë objekt, të ndërtuar me lejen e ndërtimit nr. \*\*\*, datë 13.7.2001, i shoqëruar me dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor të lejes së sheshit të ndërtimit, lejes së ndërtimit dhe regjistrimit të pasurisë (duke përfshirë edhe planvendosjen e pasurisë). Në përgjigje, subjekti depozitoi edhe një herë shpjegimet dhe dokumentacionin e depozituar më parë në Komision, pa iu përgjigjur dhe pa dhënë shpjegime mbi atë çfarë Komisioni i ka kërkuar nëpërmjet pyetësorit nr. 4.

***Në lidhje me vlerën e investimeve të kryera në ndërtesën godinë 3-katëshe***

---

<sup>8</sup> Pyetësori nr. 2.

<sup>9</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2023.

<sup>10</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot, datë 29.6.2023

<sup>11</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 4.

**37.18** Në deklaratimet pranë ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar për këtë objekt investimet dhe vlerën e tyre nga viti 2003 deri në vitin 2006.

**37.19** Në deklaratën e para fillimit të detyrës të vitit 2003, subjekti ka deklaruar se ndërtimi ka filluar nga viti 1992. Nëpërmjet pyetësorit nr. 4, subjektit i janë rikërkuar shpjegime mbi ndryshimet e bëra në këtë objekt nga viti 1992 e në vijim, për të cilat nuk dha shpjegime të mëtjetshme.

**37.20** Për të dokumentuar dhe vërtetuar shpenzimet e kryera në këtë pasuri, subjekti ka depozituar fotokopje të dokumentacionit nga viti 1993 e në vijim<sup>12</sup>, si dhe kopje të deklaratave të thjeshta të shoqërive apo subjekteve private mbi shërbimet e bëra në vite në këtë pasuri.

**37.21** Komisioni llogariti vlerën e investimeve të kryera nga subjekti mbi këtë ndërtesë, duke u mbështetur në provat e përcjella nga subjekti me deklaratën *Vetting* (mandatpagesat bankare të vitit 1993) dhe në sipërfaqen e ndërtimit 130 m<sup>2</sup> për çdo kat sipas vërtetimit hipotekor të ASHK-së Vlorë, datë 21.3.2005<sup>13</sup>. Gjithashtu, vlerat e deklaruara nga subjekti u krahasuan me referencat e EKB-së për vitet 2001 – 2005, nga sa rezultoi se shumatat e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike janë rreth vlerave të këtyre referencave<sup>14</sup>. Për këtë arsye, vlerat e investimit të përfshira në analizën financiare të Komisionit janë llogaritur sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:

**Tabela nr. 1**

Viti	1992 – 1993	2001 – tetor 2003	2004	2005	2006
Investimet e llogarisë sipas mandatpagesave bankare, viti 1993	165,000 lekë				
Vlera e deklaruar nga subjekti në DIPP/2003		7,000,000 lekë (ka përfunduar karabinaja e të gjithë godinës 3-katëshe			
Vlera e deklaruar nga subjekti në DIPP/2004			1,700,000 lekë		
Vlera e deklaruar nga subjekti në DIPP/2005				1,233,300 lekë (shtesa e objektit 3-katësh, vlera 10.000 USD + 200.000 lekë)	

<sup>12</sup> Fotokopje të kontratës së ndërtimit datë 20.5.1993 (bashkëlidhur kopje mandatarkëtimi nr. \*\*\*, në shumën 100,000 lekë, datë 10.11.1993); kontratë datë 10.8.2001, për punime me shoqërinë ndërtuese “B” sh.p.k.; mandatarkëtim datë 24.10.2004, për shumën 2,250 lekë; kopje preventivi (mungon koha e përpilimit të këtij preventivi dhe viti i shpenzimeve të bëra për secilin kat) të k/teknikut D. K. për punimet në fazën e ndërtimit të godinës trikatëshe për ambientet e katit të dytë dhe të tretë, gjithsej për të dyja katet në vlerën 1,409,000 lekë x 2 = 2,818,000 lekë.

<sup>13</sup> Aneks nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>14</sup> Sipërfaqja e llogaritur për të gjithë ndërtesën 3-katëshe është 130 m<sup>2</sup> x 3 = 390 m<sup>2</sup>. Duke llogaritur se karabinaja ka përfunduar në vitin 2004 dhe me supozimin se ajo konsiston në 80% të ndërtimit, atëherë mesatarisht janë kryer 20% e punimeve në këto vite. E thënë ndryshe, në vitin 2001 është kryer mesatarisht vlera e investimit prej 2,840,604 lekësh; në vitin 2002, vlera 2,618,538 lekë; në vitin 2003, vlera e investimeve 2,145,312 lekë dhe në vitin 2004 janë kryer edhe 1,958,814 lekë. Pra, totali 9,563,268 lekë nga vlera e deklaruar deri në vitin 2004 nga subjekti prej 8,865,000 lekësh. Pra, përfshirja e llogaritjeve në analizë, me referencat e EKB-së, nuk do ta ndryshonte situatën ekonomike të subjektit, duke iu referuar analizës financiare gjithëpërfshirëse deri në vitin 2016 të tij, paraqitur më poshtë në rezultate.

Vlera e shpenzime të deklaruara nga subjekti në DIPP/2006					160,000 lekë
<b>TOTALI</b>	<b>Vlera totale e godinës 3-katëshe është 10,258,300 lekë</b>				

### ***Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie***

**37.22** Subjekti ka deklaruar se burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer:

- kursimet familjare, të ardhurat nga puna si avokat, pagat si përmbarues, sekretar, gjyqtar, të ardhurat nga kopshti privat, dhënia me qira e zyrave, të ardhurat nga depozita bankare në BKSH, BKT, Raiffeisen Bank, Credit Agricole (ish-Emporiki Bank);
- kredia bankare në shumën 20,000 USD në BKT, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.4.2005, kontratë hipoteke pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*;
- kontrata e huadhënies me interes 6% në muaj, në shumën 1,000,000 lekë, sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 10.5.1996, huadhënës biznesmeni A.M;
- të ardhurat e tjera, të cilat gjatë punës si avokat deklarohen se ka bërë edhe shkëmbim valute, nga ku pretendon se ka nxjerrë përfitime në të ardhura në treg të lirë.

### **37.23 Në lidhje me kursimet nga aktivitete të ndryshme, subjekti ka deklaruar se ka përfituar të ardhura:**

- Nga emigracioni për një periudhë 7-mujore në shtetin grek, në vlerën totale 1,500,000 dhrahmi greke ose rreth 470,667 lekë. Subjekti nuk përcolli prova shteruese për provueshmërinë e vlerës së përfituar prej tij në këtë periudhë dhe mbi ligjshmërinë e tyre. Për këtë arsye, nuk janë përfshirë në analizë të ardhurat nga emigracioni.
- Nga ushtrimi i profesionit të avokatit për periudhën 1992 – 2000. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka përcjellë kopje të vërtetimit nga Dega e Sigurimeve Shoqërore Vlorë, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ka kryer pagesa për kontributet e sigurimeve shoqërore për pagë minimale për periudhën 1992 – 1999. Gjithashtu, subjekti ka përcjellë edhe kopje të mandatpagesave bankare pranë Bankës së Shtetit dhe Bankës së Kursimeve, fletënjoftim për pagesë tatimi, mandatpagesa për kryerjen e pagesës pranë zyrës së tatimeve etj., për pagesën ndaj tatim-taksave për aktivitetin e avokatisë për periudhën shtator 1992 – 1999.
- Në deklaratën *Vetting*, subjekti deklaron: *“Të ardhura nga puna 10 vjet si avokat dhe 4 vjet si gjyqtar... Vlera: 16,400,000 lekë”*. Në deklaratën e vitit 2003, subjekti deklaron të ardhurat e viteve 1992 – 1999<sup>15</sup>. Në total deklarohen vlerën 13,800,000 lekë, të ardhura nga aktiviteti i avokatisë.

**37.24** DPT-ja<sup>16</sup> nuk konfirmon të ardhura të deklaruara për këtë periudhë. Bashkia Vlorë<sup>17</sup> konfirmon se shtetasi Hektor Sinanaj nuk rezulton të ketë NIPT në QKB dhe nuk figuron i regjistruar në kontabilitetin e tyre. DRT Vlorë<sup>18</sup> konfirmon se shtetasi Hektor Sinanaj rezulton i regjistruar me vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 5.5.1992, si person fizik, me aktivitetet avokat dhe

<sup>15</sup> Viti 1992, shuma e së ardhurës 1,000,000 lekë; viti 1993, të ardhura në shumën 1,200,000 lekë; viti 1994, të ardhura në shumën 1,500,000 lekë; viti 1995, të ardhura në shumën 2,000,000 lekë; viti 1996, të ardhura në shumën 2,400,000 lekë; viti 1997, të ardhura në shumën 500,000 lekë; viti 1998, të ardhura në shumën 1,800,000 lekë; viti 1999, të ardhura në shumën 3,400,000 lekë.

<sup>16</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2023.

<sup>17</sup> Aneks nr. 34, shkresa datë 4.7.2017.

<sup>18</sup> Aneks nr. 4/12.

kod fiskal nr. \*\*\*, për të cilin konfirmohen pagesa e kryera në këtë zyrë në vitin 1998 – 1999. Ndërsa në lidhje me dokumentacionin e përcjellë nga subjekti pranë tyre (ripërcjellë bashkëlidhur deklaratës *Vetting*), shprehen se nuk mund të pranohen të vendosen në dosjen e tyre fizike pranë arkivit të DRT Vlorë, sepse janë dokumente të cilat duhet të vendoseshin në dispozicion që në momentin që janë kryer pagesat pranë bankave dhe se DRT Vlorë e ka të pamundur të shprehet lidhur me origjinalitetin e tyre.

**37.25** Në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, përcjellë subjektit me rezultatet e hetimit, nuk u përfshinë të ardhura nga avokatia, pasi gjatë hetimit nuk u arrit të provohej nga përgjigjet e administruara nga institucionet vlere reale/konkrete e të ardhurave të fituara dhe shlyerja e detyrimeve tatimore për këtë aktivitet.

**37.26** Gjithashtu, subjekti deklaron të ardhura nga paga si përmbarues, sekretar etj., që i përkasin periudhës përpara vitit 1990, të cilat nuk janë përfshirë në analizë, pasi nisur nga praktika e Komisionit dhe Kolegjit çmohet se aftësia për kursim gjatë kësaj periudhe nuk ka qenë e mundur vetëm me të ardhurat nga pagat.

**37.27** Të ardhurat e deklaruara nga subjekti nga aktiviteti privat bilardo nuk janë përfshirë në analizë, pasi mungon elementi i provueshmërisë dhe ligjshmërisë së tyre. Përveç deklaramit të subjektit, nuk rezultojnë prova për këto të ardhura.

**37.28** Të ardhurat nga kopshti privat nuk provohen që të kenë shërbyer si burim për ndërtimin e godinës, pasi regjistrimi i tij në MASH dhe në drejtoritë tatimore është kryer në vitin 2008, kur ndërtimi kishte përfunduar nga viti 2006.

**37.29** Të ardhurat nga interesat e depozitave bankare për këtë periudhë nuk janë përfshirë në analizë, pasi nuk provohen nga komunikimi me bankat që të jetë përfituar përpara vitit 2008.

**37.30** Shuma e kredisë bankare: Nga hetimi i Komisionit rezultoi<sup>19</sup> se subjekti kishte lidhur kontratë kredie në datën 11.4.2005, në shumën 20,000 USD, ose e konvertuar në rreth 2,066,600 lekë. Kjo vlerë është tërhequr nga subjekti në ditën e disbursimit të saj. Vlora e kredisë dhe mënyra e shlyerjes së saj janë përfshirë në analizën financiare dhe si burim krijimi të pasurisë.

**37.31** Gjithashtu, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të tij vlerën e kthimit të huas nga shtetasi A.M, në shumën 1,000,000 lekë, sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 10.5.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>20</sup>.

### **Lidhur me të ardhurat nga pagesat e qirave**

**37.32** Rezulton se subjekti ka filluar të deklarojë për herë të parë në DIPP-në e vitit 2004 të ardhura nga qiraja e zyrave dhe bilardos (në këtë DIPP vlere e të ardhurave është 823,000 lekë). Deklarimet për të ardhurat nga qiratë janë deklaruar për çdo vit në ILDKPKI, deri në vitin 2016. Në deklaratën *Vetting*, vlere e deklaruar nga subjekti për të ardhurat nga qiratë është 8,522,000 lekë dhe 36,000 euro. Subjekti ka shpjeguar gjatë procesit të rivlerësimit dhe në deklaratën *Vetting* se vetëm pas daljes së VKM-së, në tri vitet e fundit (subjekti i referohet tri viteve nga

<sup>19</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 5.7.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2021, të BKT-së.

<sup>20</sup> Vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 10.5.1996, i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me palë paditëse shtetasin Hektor Sinanaj dhe palë të paditur shtetasin A.M, me objekt “Detyrimin e të paditurit sipas kontratës së datës 19.1.1995, për huadhënien në shumën 1,000,000 lekë, me interes 6% në muaj”. Referuar vendimit, rezulton se i padituri ka shlyer shumën 400,000 lekë dhe për shkak të interesit duhet të shlyejë edhe pjesën e mbetur, rreth 955,903 lekë.

plotësimi i deklaratës *Vetting*, 2014 – 2017) ka filluar të hartojë akte noteriale për hartimin e kontratave të qirasë dhe se sipas ligjit tatimi paguhet nga qiramarrësi, ndërsa qiradhënësi e llogarit paraprakisht në çmimin e kontratës. Gjithashtu, në pyetësonin standard, subjekti përcjell kopje kontratash qiraje dhe listë të individëve me të cilët ka lidhur kontrata qiraje nga viti 2000 e në vijim, si dhe vlerat e përfituara për secilën kontratë. Ndërsa nga përgjigja e ardhur nga DPT-ja<sup>21</sup> nuk përcillet asnjë informacion në lidhje me shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiraja prej subjektit ose bashkëshortes së tij.

**37.33** Sipas parashikimeve<sup>22</sup> të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në nenin 8 “E ardhur e tatueshme” dhe sqarimeve në pikën 2.3.6 të udhëzimit nr. 5 datë 30.1.2006, i ndryshuar, përcaktohet se:

a) Në rastin e marrëdhënies së qiradhënies të lidhur midis dy individëve dhe kur nuk është përcaktuar ndryshe në kontratë, detyrimi tatimor mbi vlerën e qirasë do të përmbushet nga individi përfitues.

b) Ndërsa në rastin e marrëdhënies së qiradhënies të lidhur midis një individi dhe personi (të tatueshëm) juridik, sipas përcaktimeve në nenin 33 të ligjit nr. 8438, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, detyrimi tatimor do të përmbushet nga personi juridik vetëm nëse në kontratë është përcaktuar ndryshe.

Në rastin e subjektit rezultoi se kontratat e qirave përgjithësisht ishin verbale, siç deklaroi edhe vetë ai në deklaratën *Vetting* dhe vetëm në 3 vitet e fundit këto kontrata janë lidhur në prani të noterëve publikë. Në kontrata nuk përcaktohet se cila palë ka përgjegjësinë tatimore dhe nuk ishin lidhur sipas përcaktimeve ligjore, trajtuar sa më lart. Nga hetimi nuk rezultoi të jenë shlyer detyrimet tatimore për këto të ardhura të fituara nga qiratë dhe as nuk rezultoi të jetë mbajtur tatimi në burim nga njëra prej palëve. Sa më lart, Komisioni nuk i përfshiu në analizën e tij të ardhurat nga qiraja.

**37.34** Në vijim, Komisioni hartoi analizën financiare të subjektit për periudhën e investimit në objekt deri në datën 31.12.2006, e cila paraqitet si më poshtë:

**Tabela nr. 2**

Vitet	06.03.2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
<b>TË ARDHURA</b>							
Të ardhura nga paga e subjektit pranë gjykatës V*	315,635	439,581	473,304	590,442	806,713	808,295	827,010
Të ardhura nga vendimi i gjykatës i vitit nr. * dt. 10.05.1996 për kthimin e shumës së dhënë lua me interes për vlerën 1,000,000 Lekë nga shtetasi A* M*.							
Të ardhura nga avokatia shtator 1992-1999							
<b>PASURI</b>	-	<b>3,317,041</b>	<b>2,667,041</b>	<b>3,367,041</b>	<b>2,033,708</b>	<b>2,440,355</b>	<b>940,653</b>
Shtëpi banimi në një sipërfaqe trualli 162 m <sup>2</sup> , në L.“P**”, V*. Burimi i krijimit: Trashëgimi dhe dhurim. Rikonstruktuar me shpenzimet e kryera deri në dhjetor 2005 vlera e situacionit 1,668,540 leke		333,708	333,708	333,708	333,708	333,708	
Ndërtesë 3 kate, me adresë në lagjen I* B* V*, e ndërtuar nga fundi i vitit 1992, rikonstruktuar deri në vitin 2006. Vlera gjithsej sipas situacionit për periudhën nga data 1.7.2001 deri në datë 31.3.2006 në shumën 9,194,890 lekë. Përshtatur për ambiente zyra dhe aktivitete të tjera private.		2,333,333	2,333,333	2,333,333	1,700,000	1,233,300	160,000
Pasuria njësi 60 m <sup>2</sup> dhe trualli i njësisë, me certifikatat përkatëse të pronësisë lëshuar datë 8.9.2006. Mbi katin ekzistues, legalizuar shtesë kati, lëshuar Certifikata e pronësisë datë 4.1.2011. Vlera 650,000 lekë, blerë me kontrate dt.14.8.2001. Vlera gjithsej sipas situacionit 1.7.2005-31.3.2006 në shumën 1.645,290 lekë		650,000				834,270	834,270
Automjet tip Benz me targa V* dhe V*, blerë në vitin 1995, në shumën 500,000 lekë. Shitur më pas me kontratë dt. 27.5.2008 në shumën 250,000 lekë.							
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë dhe CASH				700,000		39,077	(53,617)
<b>DETYRIME</b>					<b>(700,000)</b>	<b>1,693,413</b>	<b>(499,335)</b>
Huadhënia shtetasi A* S* në vlerën 400,000 lekë				400,000	(400,000)		
Huadhënia shtetasi S* R* në vlerën 300,000 lekë				300,000	(300,000)		
Kredi bankare B* dt. 13.04.2005 vlera 20,000 usd për rikonstrukcion dyqani në katin dyte						1,693,413	(499,335)
<b>SHPENZIME</b>	<b>450,000</b>	<b>504,660</b>	<b>469,320</b>	<b>469,820</b>	<b>469,820</b>	<b>633,920</b>	<b>1,302,634</b>
Shpenzime shkolliimi për fëmijët						86,135	253,849
Shpenzime arredimi dhe mobilimi sipas pyetësonit standart							501,000
Shpenzime jetike	450,000	504,660	469,320	469,820	469,820	547,785	547,785
<b>Rezultati financiar</b>	<b>(134,365)</b>	<b>(3,382,120)</b>	<b>(2,663,057)</b>	<b>(2,546,419)</b>	<b>(2,396,815)</b>	<b>(572,567)</b>	<b>(1,915,611)</b>

<sup>21</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2021.

<sup>22</sup> Shkresë e DTP-së nr. \*\*\* prot., datë 10.4.2018, drejtuar Komisionit.

Nga analiza financiare rezultoi se gjatë gjithë periudhës së ndërtimit dhe investimit në ndërtesat e deklaruara nga subjekti, analiza financiare e Komisionit është me vlerë negative për çdo vit, pra subjekti nuk ka pasur mundësi të krijojë pasurinë me të ardhura të ligjshme.

### **Lidhur me trajtimin e konfliktit i interesit**

**37.35** Subjekti i rivlerësimit Hektor Sinanaj ka deklaruar në vite në ILDKPKI të ardhura nga qiraja nga kjo pasuri.

**37.36** Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi. Për këtë iu drejtua subjektit për të dhënë shpjegime nëse janë gjykuar çështje civile/administrative/penale me palët me të cilët ky subjekt kishte lidhur kontratat e qirave nga viti 2000 e në vijim.

**37.37** Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka dhënë shpjegime, nëpërmjet të cilave ka deklaruar se nga viti 2000 e në vijim një numër i madh avokatësh kanë përdorur ambientet e godinës 3-katëshe si zyra kundrejt pagesës së qirave ndaj tij. Në shpjegim cilësohen me emra për secilin avokat dhe vitet që ata kanë qenë qiramarrës në godinën e regjistruar karabina në emër të tij. Gjithashtu, krahas avokatëve, subjekti deklaroi se në ambientet e kësaj godine kanë marrë zyra me qira edhe ekspertë apo persona fizikë. Bashkëlidhur përgjigjeve subjekti ka sjellë edhe kopje të vendimeve gjyqësore, në të cilat këta avokatë kanë qenë përfaqësues të palëve ndërgjyqëse në gjykimet e tij si gjyqtar në vite.

**37.38** Gjithashtu, edhe nga përgjigja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë konfirmohet një numër i konsiderueshëm vendimesh gjyqësore, ku subjekti Hektor Sinanaj në mënyrë të vazhdueshme nga viti 2000 e në vijim ka gjykuar çështje ku këta avokatë të deklaruar si qiramarrës kanë qenë përfaqësues të palëve në procese gjyqësore të gjykuara nga subjekti ndër vite.

**37.39** Analiza e konfliktit të interesit është trajtuar në pikën 93 të këtij vendimi, në vijim të vlerësimit profesional.

**37.40** Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të vërtetuar të kundërtën e sa rezultuar nga hetimi, si vijon:

- Është e paqartë mënyra e përfitimit të truallit në vitin 1992, mbi të cilin më vonë u ndërtua godina aktuale 3-katëshe.
- Është e paqartë juridikisht se cilat janë arsyet që kjo godinë e filluar të ndërtohet në vitin 1992 sot figuron ende e regjistruar “karabina”.
- Subjekti rezulton me pamundësi financiare për ndërtimin e godinës 3-katëshe për të gjithë vlerën e saj, sipas deklaramit të tij, në shumën -10,258,300 lekë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**37.41** Subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, por edhe në prapësime, në lidhje me pronësinë e truallit, është shprehur se ai është njohur pronar me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në vitin 1996 dhe se ky vendim nuk mund të përbëhet objekt shqyrtimi i procesit të rivlerësimit, pasi do të cenohej siguria juridike nëse do të vinim në diskutim çdo vendimmarrje të gjykatave shqiptare. Më tej, shpjegon se në vitin 1996 është certifikuar pronësia e ndërtimit dhe truallit, duke e njohur atë pronar dhe për ta regjistruar pasurinë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

**37.42** Në lidhje me të ardhurat nga emigracioni, subjekti shpjegon se provat e paraqitura në Komision tregojnë faktin se ka punuar në vitin 1991 në shtetin grek dhe se ka përfituar të ardhura nga emigracioni, të cilat ishin të konsiderueshme në raport me ndryshimin e ekonomisë që ekzistonte në Shqipëri, dhe që i kanë shërbyer për të kryer investimet e para për ndërtesë dhe të fillonte aktivitetin si avokat.

**37.43** Në lidhje me të ardhurat nga avokazia, të cilat nuk janë përfshirë në analizën financiare nga Komisioni, subjekti shprehet se është provuar se ai ka qenë i regjistruar në organet tatimore, ku edhe ka kryer pagesat e tatimeve për vitin 1998 – 1999. Meqenëse dokumentacioni i dërguar në Komision nuk është pranuar, ai ka depozituar një kërkesëpadi në gjykatë për njohjen e vërtetësisë së këtyre dokumenteve dhe është në pritje të zgjidhjes së çështjes nga gjykata kompetente.

**37.44** Në lidhje me pagesat e qirave, subjekti shprehet se këto të ardhura i provon me kontratat e qirave të paraqitura pranë Komisionit, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, në interpretim të ligjit tatimor, detyrimi tatimor duhet të përmbushet nga personi i tatueshëm i regjistruar në organet tatimore dhe që ushtron veprimtari tregtare. Sipas subjektit, deklaratimet noteriale të qiramarrësve provojnë se këto ambiente i kanë marrë me qira për ushtrimin e aktivitetit tregtar/profesional të regjistruar në organet tatimore dhe, si rrjedhojë, kanë qenë ata të detyruar të paguajnë detyrimet tatimore.

**37.45** Në lidhje me të ardhurat për krijimin e pasurive, subjekti shprehet se rezultati i Komisionit ka rezultuar negativ, për shkak se në të nuk janë përfshirë të ardhurat nga puna e avokatisë dhe të ardhurat nga qiratë, të cilat duhet të pranohen sepse është paguar tatimi në burim.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**37.46** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës – arsyeton se:

**37.47** Subjekti i rivlerësimit edhe pas kalimit të barrës së provës nuk arriti të qartësojë mënyrën e fitimit të pronësisë mbi këtë truall, duke e lënë të pavlerësuar në mënyrë të plotë këtë pasuri për sa i përket aktit ligjor të përfituar.

**37.48** Në analizë të burimeve të ligjshme të pasurisë, Komisioni çmon se rezultoni e provuar se subjekti ka ushtruar profesionin e avokatit për periudhën 1992 – 1999, duke u regjistruar me vendimin e gjykatës nr. \*\*\*, datë 5.5.1992, si person fizik, me aktivitet avokat, në organet tatimore rajonale, me kod fiskal nr. \*\*\*, pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore për pagën minimale, mandatpagesat pranë Bankës së Shtetit dhe Bankës së Kursimeve, mandatpagesat për kryerjen e pagesës pranë zyrës së tatimeve etj. Gjithashtu, subjekti bën deklaratim të detajuar në deklaratën e parë (viti 2003) për të ardhurat e realizuara për çdo vit të kryerjes së këtij aktiviteti dhe nga institucionet konfirmohen pagesat për shlyerjen e detyrimeve tatimore prej tij në vitet 1998 – 1999.



**37.49** Komisioni vlerësoi se duke u nisur nga koha e gjatë e arkivimit të të dhënave, subjekti ka mundësi të provojë shumat konkrete të përfituara prej tij apo/dhe shumat e detyrimeve tatimore të shlyera prej tij për këtë aktivitet. Komisioni do të përfshijë në analizën financiare të ardhurat neto të llogaritura me marzhin e fitimit 90% për qarkullimin minimal prej 2,000,000 lekësh në vit, për periudhën shtator 1992 – 1999, duke u mbështetur në praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit<sup>23</sup> mbi të ardhurat nga ushtrimi i veprimtarisë së avokatisë. Komisioni çmon se e ardhura totale që duhet të përfshihet në analizën financiare nga ushtrimi i veprimtarisë së avokatisë prej subjektit është 13,500,000 lekë, por edhe pas përfshirjes së tyre në analizën financiare situata financiare e subjektit për periudhën e investimit (1992 – 2006) nuk rregullohet, pasi ai vazhdon të jetë me rezultat negativ, në vlerë totale për këtë periudhë prej - 9,805,956 lekësh.

**37.50 Në përfundim**, Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë se burimet për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë të krijuara në mënyrë të ligjshme, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**38. Njësi (magazinë) me sip. 60 m<sup>2</sup>**, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\* dhe **trualli i njësisë** nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me certifikatat përkatëse të pronësisë lëshuar në datën 8.9.2006. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Mbi katin ekzistues, legalizuar shtesë kati me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, lëshuar certifikata e pronësisë datë 4.1.2011. Vlera 650,000 lekë, pjesa takuese 100%. Vlera 17,951 lekë, pjesa takuese 100%. Vlera gjithsej sipas situacionit 1.7.2005 – 31.3.2006 në shumën 1,645,290 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: blerë me kontratën e shitjes noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.8.2001, nga unë Hektor Sinanaj, nga shitësi bashkëpronar I e S.K, në shumën 650,000 lekë. Kati i sipërm nr. \*\*\*, legalizuar me pagesën e legalizimit datë 25.5.2009, në shumën 17,951 lekë, si dhe taksë shërbimi 4,000 lekë. Shtesa e katit është ndërtuar me kursimet familjare dhe pjesërisht edhe nga kredia bankare marrë në BKT 20,000 USD, në periudhën 2002 – 2005. Në katin e parë dhe të dytë janë bashkuar ambientet e pasurisë nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, duke u saktësuar në ZVRPP sipërfaqja e pasurisë nr. \*\*\* nga 56 m<sup>2</sup> në 60 m<sup>2</sup>”*.

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**38.1** Nga hetimi rezulton se me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.8.2001, subjekti ka blerë nga shitësit I.K e S.K<sup>24</sup> pasurinë magazinë me nr. pasurie \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*”, me përmasa 16 x 3,5 = 56 m<sup>2</sup> (kufitar nga pjesa veriore Hektor Sinani), kundrejt vlerës 650,000 lekë, shumë kjo e likuiduar plotësisht, sipas parashikimit të kontratës. Nga hetimi rezultoi se subjekti e ka regjistruar objektin me sip. 60 m<sup>2</sup> në regjistrat hipotekorë<sup>25</sup> në vitin 2006.

**38.2** Në datën 6.11.2006 ka vetëdeklaruar një shtesë mbi soletën e objektit (ish-magazinë) njësi me sip. 60 m<sup>2</sup>, me qëllim legalizimin e saj. Ndërkohë, në DIPP-në e vitit 2006 subjekti nuk e ka deklaruar këtë ndërtim informal, si dhe vlerën e shpenzimeve për ndërtimin e kësaj shtese, e cila rezulton e legalizuar dhe e regjistruar pas procesit të legalizimit në ASHK<sup>26</sup>.

<sup>23</sup> Vendim nr. 6/2022 (JR), datë 12.3.2022 dhe vendim nr. 20/2023 (JR), datë 3.5.2023.

<sup>24</sup> Kopje e vërtetimit hipotekor nr. \*\*\*, datë 27.11.1996, ku konfirmohet e regjistruar në pronësi të shtetasit I.K pasuria magazinë në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, me përmasa 16 x 3,5 = 56 m<sup>2</sup>, datë 14.8.2001.

<sup>25</sup> Certifikatë pronësie datë 8.9.2006, për pasurinë truall nr. \*\*\*, me sip. 60 m<sup>2</sup>, e ndodhur në z. k. \*\*, lagja “\*\*\*\*”, Vlorë, në pronësi të shtetasit Hektor Sinani. Bashkëngjitur kopje karteles dhe hartë treguese për këtë pasuri.

<sup>26</sup> Certifikatë pronësie datë 4.1.2011, për pasurinë njësi nr. \*\*\*, me sip. 60 m<sup>2</sup>, e ndodhur në z. k. \*\*\*, lagja “\*\*\*\*”, Vlorë, në pronësi të shtetasit Hektor Sinani. Bashkëngjitur kopje karteles dhe hartë treguese për këtë pasuri.

**38.3** Nga hetimi rezultoi se subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në vitin 2011, ku ka deklaruar vetëm vlerën që ka paguar për procesin e legalizimit, por pa deklaruar vlerën e investimit të bërë për të.

**38.4** ASHK Drejtoria e Përgjithshme<sup>27</sup> konfirmon se subjekti i rivlerësimit rezulton aplikues në procesin e legalizimit në datën 6.11.2006 Vlorë, ku ka vetëdeklaruar ndërtimin e objektit shtesë papafingo me sip. 60 m<sup>2</sup>. Objekti është legalizuar me leje legalizimi<sup>28</sup> datë 18.10.2010, shtesë një kat për shërbim në objektin ekzistues 1 kat, Vlorë.

**38.5** Në vitin 2015, shtetasi TH.B ka paditur ALUIZNI-n dhe person të tretë shtetasin Hektor Sinanaj, me objekt “Revokim të aktit administrativ dhe vazhdimin e legalizimit për objektin e tij”. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.1.2013, të Gjykatës së Shkallës së Parë, është vendosur: “Rrëzimi i kërkesëpadisë”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me nr. \*\*\*, datë 11.9.2014 dhe nga Gjykata e Lartë është vendosur mospranimi i rekursit.

**38.6** Gjatë hetimit, subjekti ka dhënë shpjegime të shoqëruara me dokumentacion ligjor për kohën e fillimit të ndërtimit, mbarimit të ndërtimit të shtesës të kryer në objekt; vlerën e investimit të kryer për shtesën të ndarë sipas viteve përkatëse; vlerën e investimit në godinën ish-magazinë, kthyer në njësi; nëse ka kryer punime të tjera ndërtimi përveç shtesës së legalizuar me lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 18.10.2010 dhe sa është vlera e tyre. Subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Objekti shtesa anësore për kopsht fëmijësh, lagjja “\*\*\*”, investimi i katit të parë dhe të dytë janë bashkuar me ambientet e pasurisë dhe kapin shumën 1,645,290 lekë, duke u saktësuar në ZVRPP sipërfaqja e pasurisë nr. \*\*\* nga 56 m<sup>2</sup> në 60 m<sup>2</sup>. ...shtesa në katin e dytë ishte e filluar nga ish-pronari i mëparshëm... deklarimi mban datën 6.11.2006, që përkon pas përfundimit të shtesës që ka përfunduar sipas situacionit më 31.3.2006...”*. Lidhur me vlerën e investimeve të kryera për shtesën, të ndarë sipas viteve përkatëse, në godinën ish-magazinë, kthyer në njësi, subjekti shprehet se vlera del nga përshkrimi në këto deklarata të investimeve. Lidhur me faktin nëse ka kryer punime të tjera, ai shprehet se në ambientin e brendshëm të shtesës ka përshtatur me ndarje mur kartonxhesi një derë tamburato, dy ambiente me destinacion zyra, në vlerën e materialeve në shumën 45,000 lekë pa vlerën e punës, pasi shprehet se i ka bërë vetë disa prej këtyre punimeve.

**38.7** Në vitin 2015, pranë ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar vetëm se kjo njësi i përket magazinës me sip. 56 m<sup>2</sup> të deklaruar në vitin 2003, e cila kur është legalizuar në vitin 2011 është saktësuar sipërfaqja 60 m<sup>2</sup>.

**38.8** Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë<sup>29</sup> konfirmoi se gjatë kohës së ushtrimit të detyrës së gjyqtarit për periudhën 2000 e në vijim subjekti nuk ka gjykuar çështje të çfarëdolloj cilësie, ku palë ndërgjyqëse të kenë qenë shtetasit I.K dhe S.K.

### **Lidhur me burimin financiar të krijimit**

<sup>27</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 16.3.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2023.

<sup>28</sup> Bashkëngjitur përgjigjes së ASHK-së: genplan; ortofoto; planimetri; mandatpagesë datë 30.4.2009, në shumën 4,300 lekë, kryer nga shtetasi Hektor Sinanaj, në favor të ALUZNI-t, si dhe formular i tarifës së shërbimit në vlerën 4,000 lekë; mandatpagese datë 25.5.2009, në shumën 17,951 lekë, i kryer nga shtetasi Hektor Sinanaj, në favor të ALUZNI-t, si dhe formular i tarifës së shërbimit në shumën 16,951 lekë, që i takon 1% e vlerës së investimit në shumën 1,695,120 lekë. Bashkëlidhur me aktet janë edhe kopje të certifikatave të vërtetimit të pronësisë për truallin, njësinë dhe shtesën (secila me sip. 60 m<sup>2</sup>).

<sup>29</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2023.

**38.9** Subjekti ka deklaruar se për krijimin e pasurisë njësi (ish-magazinë) ka shërbyer kontrata e shitjes noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.8.2001, në shumën 650,000 lekë, por nuk ka deklaruar burimin e kësaj shume në momentin e blerjes në vitin 2001. Ndërsa në lidhje me burimin e shtesës, subjekti deklaroi se shtesa e katit është ndërtuar me kursimet familjare pjesërisht dhe nga kredia bankare marrë në BKT në vlerën 20,000 USD, në periudhën 2002 – 2005.

**38.10** Nga hetimi rezulton e provuar kredia me kontratën e kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.4.2005, të lidhur midis subjektit dhe bashkëshortes të tij dhe Bankës Kombëtare Tregtare, ku është kredituar kredia në shumën 20,000 USD, me afat 60 muaj, me qëllim konstruksionin e dyqanit në katin e dytë.

**38.11** Subjekti në lidhje me vlerën e investimit në ndërtesë përcolli kopje të situacionit për periudhën 1.7.2005 – 31.3.2006, në shumën 1,645,290 lekë dhe kopje të pagesave të Credins Bank të tarifave të shërbimit për legalizim në vitin 2009, në vlerat 4,300 lekë, 4,000 lekë dhe 17,951 lekë.

**38.12** Komisioni hartoi analizën financiare<sup>30</sup> për burimin e krijimit të pasurisë, për të cilën deklarohet se ka përdorur të njëjtat burime si trajtuar në pasurinë nr. \*\*\* më lart. Nga analiza financiare e paraqitur në tabelën nr. 2 (më lart) rezulton se subjekti ka pamundësi në shumën - 2,318,540 lekë për krijimin e pasurisë me të ardhura të ligjshme.

**38.13** Komisioni në përfundim të hetimit i kaloi barrën e provës subjektit, për sa më poshtë:

- Ka mospërputhje të vlerës së deklaruar për blerjen e ish-magazinës në DIPP-në e vitit 2003, 1 milion lekë, me vlerën e parashikuar në kontratën e shitblerjes, 650,000 lekë.
- Shtesa e ndërtuar nuk është deklaruar në DIPP-të e viteve 2005 – 2010, si dhe në DIPP-në e vitit 2011 nuk është deklaruar vlera e investimit dhe burimi i krijimit të saj.
- Subjekti ka bërë një deklaram të paqartë në lidhje me vlerën e investimit në secilin vit, duke e bërë të pamundur analizën e plotë të kësaj pasurie, në kuptim të ligjit nr. 84/2016.
- Subjekti rezulton me pamundësi financiare për ndërtimin e shtesës, në vlerën -2,318,540 lekë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**38.14** Subjekti i rivlerësimit, gjatë prapësimeve është shprehur se për këtë pasuri vlera totale prej 2,318,540 lekësh përbëhet nga shuma e përgjithshme e vlerës së investimit dhe vlerës së kontratës së shitblerjes. Vlera e deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, prej 1,000,000 lekësh, nuk përbën vlerën e kontratës së shitblerjes për këtë pasuri, por është edhe vlerë investimi, në funksion të dy pasurive, pasi godina trikatëshe qëndron e bashkuar me njësinë e regjistruar veçmas. Në proces legalizimi nuk ka pasur ndërtim shtesë, por është regjistruar restaurimi i njësisë ekzistuese të blerë me kontratën e shitjes noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.8.2001. Për vlerën e investimit prej 1,645,290 lekësh subjekti shprehet se është e pasqyruar qartë edhe periudha e investimit, nga data 1.7.2005 deri më 31.3.2006.

### **Vlerësimi i Komisionit**

---

<sup>30</sup> Për më tepër drejtojuuni rezultateve të hetimit.

**38.15** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës – arsyetoni se:

**38.16** Subjekti i rivlerësimit edhe pas kalimit të barrës së provës përforcoi dhe një herë qëndrimet e tij kontradiktore lidhur me kohën dhe vlerën e këtij investimi, duke e bërë të pamundur analizën financiare dhe kontrollin e ligjshmërisë së krijimit të kësaj pasurie. Komisioni, në lidhje me analizën financiare, në mungesë të deklaratimit në mënyrë të qartë dhe të pambështetur në prova të vlerës së këtij ndërtimi, ka vlerësuar se subjekti nuk shpjegoi në mënyrë shteruese pamundësinë financiare të rezultuar gjatë hetimit administrativ prej - 2,318,540 lekësh.

**38.17 Në përfundim**, Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë se burimet për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë të krijuara në mënyrë të ligjshme, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**39. Shtëpi banimi**, në një sipërfaqe trualli prej 162 m<sup>2</sup>, lagjja “\*\*\*\*”, Vlorë, zona kadastrale \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*. Vlera: 1,668,540 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: trashëgimi<sup>31</sup>.

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**39.1** Nga hetimi rezultoi se kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti në DIPP-në e vitit 2003.

---

<sup>31</sup> Subjekti vazhdon deklaratimin në deklaratën *Vetting*: “*Ekzistuese ka qenë në pronësi të gjyshit nga nëna B.G, sipas notë transkriptimit me nr. radhor \*\*\*, vol. \*\*\*, datë 21.8.1936. Më është dhuruar nga nëna ime gjysma e banesës, me akt dhurimin datë 30.10.1992. Gjysma tjetër e banesës në pronësi të tezes sime M.H (G), duke pasur kontradikta për posedimin, ia shiti vjehrrit tim S.R, i cili më pas ma kaloi me akt dhurimin nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.4.1995, duke kaluar e regjistruar e gjithë banesën në Hipotekë, në nenet \*\*\*, datë 8.2.1994 dhe \*\*\*, datë 13.4.1995 tek unë si pronar gjithë banesa. Këtë banesë, duke filluar që nga koha që kam banuar dhe pas dhurimit nga nëna, e pjesës tjetër nga vjehrrit, në vazhdimësi e kam rikonstruktuar, duke i hequr çatinë ekzistuese (papafingo), duke e bërë çati (papafingo) të re, me ambiente të përshkruara në certifikatën përfundimtare të pronësisë, shënuar në fillim të përshkrimit, lëshuar nga ZVRPP Vlorë, datë 21.11.2007, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*. Rikonstruktuar me shpenzimet e kryera nga data 4.12.1992 deri në dhjetor 2004. Të ardhurat e siguruara nga puna: para datës 4.12.1992 kam qenë gjithmonë i angazhuar në punë me pagë dhe të ardhura më vete: Në Nd. Shpendëve Vlorë nga 29.6.1983 – 28.8.1984. Sekretar gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë nga data 28.8.1984 deri më 16.3.1988. Përmbartues gjyqësor deri në datën 31 tetor 1990. Në këtë datë të fundit, kaluar avokat në Kolegjin e Avokatëve Vlorë, emërimet nga Ministria e Drejtësisë, periudha 31 tetor 1990 deri në gusht 1991, datë në të cilën kam shkuar emigrant në Greqi, me vizë nga Ministria e Shëndetësisë për vizitë mjekësore të kunatit R.R, kthyer në nëntor 1991, hyrje përsëri në fund të nëntorit 1991, kthim me 1 mars 1992. Në Greqi kam punuar në punë të ndryshme, kryesisht punë krahu e dizeno në qytetet N. e I, Greqi, banuar në banesë me qira tek sahati i qytetit dhe në I. tek një banesë ish-shkollë. Emri i pronarit në N, XH.C “P”, punuar punë dizeno e transport mallrash. Po në N tek pronar K. S. SH – N. Në I, Greqi, mbledhje ullinj, tek pronar mësues shkollë, i ati mësues i vjetër i qytetit I, shkolla e vjetër si muze në periferi të qytetit. Të ardhura nga puna në Greqi 1,000,000 dhrami, të konvertuara në lekë 1 x 5 = 500,000 lekë. Gjithashtu, periudhën 1984 e më pas kam pasur gjithmonë depozita kursimi në bankë, ku depozitat kanë qenë me interesa të larta nga 12% deri në 30%. Vazhduar punën në Kolegjin e Avokatëve deri në daljen si avokat privat me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.5.1992, person fizik, me nr. serial \*\*\*. Pagar rregullisht tatimet dhe sigurimet shoqërore si avokat deri në datën 6.3.2000 kur kalova gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë e vazhdoj edhe sot. Shpenzime për pasurinë nr. \*\*\*, sipas situacionit periudha 1.1.2003 – 31.12.2005, sipas faturave e deklaratave që disponoj të punimeve, duke zbritur vlerën e banesës ekzistuese (me akt dhurimi) rikonstruktuar është në shumën 1,668,540 lekë”.*

**39.2** Nga hetimi<sup>32</sup> rezultoi e provuar se kjo pronë në vitin 1936 është blerë nga shtetasi B.G (gjyshi nga nëna i subjektit), kundrejt vlerës 500 franga ari. Kjo pasuri pas ndërrimit jetë të gjyshit të tij u trashëguua nga vajzat e tij, ½ e kësaj pasurie u trashëguua nga nëna e subjektit, znj. P.S dhe ½ nga tezja e subjektit, znj. M.H.

**39.3** Me aktin e dhurimit datë 30.10.1992<sup>33</sup>, nëna e subjektit i dhuron subjektit ½ pjesë të saj të pasurisë, pjesën veriore të shtëpisë dhe oborrin përkatës.

**39.4** Në vitin 1993, subjekti i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesë për “Njohjen e pronësisë për pasurinë e përfitur me aktin e dhurimit datë 30.10.1992, që ndodhet në lagjen “\*\*\*”...”. Gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.11.1993, ka vendosur të njohë pronar të kësaj shtëpie banimi z. Hektor Sinani, gjithsej banesa dhe oborri 200 m<sup>2</sup>.

**39.5** Sipas vërtetimit të pronësisë datë 8.2.1994, vërtetohet se në pronësi të subjektit është regjistruar pasuria shtëpi banimi dhe oborri me sip. 200 m<sup>2</sup>, në Vlorë.

**39.6** Pjesa tjetër e pronës, ½ e saj, i është shitur vjehërit të subjektit, z. S.R, i cili me aktin e dhurimit datë 13.4.1995<sup>34</sup> ia ka dhuruar subjektit. Në datën 13.4.1995, kjo pronë është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

**39.7** Komisioni konstatoi se ka mospërputhje të sipërfaqes së truallit mbi të cilin është ndërtuar ndërtesa, në deklaratimet e subjektit në vite me përgjigjet e ASHK-së [para fillimit të detyrës 2003 dhe në vendimin gjyqësor të vitit 1993 sipërfaqja e truallit është 200 m<sup>2</sup>, më vonë në deklaratën *Vetting* dhe në përgjigjen e ZVRPP-së (sot ASHK) konfirmohet sipërfaqja e truallit mbi të cilën është ndërtuar banesa sa më sipër me sip. 162 m<sup>2</sup>].

### **Lidhur me burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie**

**39.8** Subjekti deklaron<sup>35</sup> se kjo pasuri është fituar me kontratë dhurimi dhe është rikonstruktuar nga data 4.12.1992 deri në dhjetor të vitit 2004 dhe se burim krijimi për këtë investim kanë shërbyer të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes nga data 29.6.1983 e në vijim.

**39.9** Në deklaratën para fillimit të detyrës 2003, subjekti për këtë pasuri ka deklaruar vlerën 4 milionë lekë. Më tej, në deklaratat periodike të viteve 2003 – 2005, subjekti nuk ka deklaruar shtesa/ndryshime apo shpenzime në lidhje me këtë pasuri, ndërkohë në deklaratën *Vetting* ka deklaruar për periudhën 1.1.2003 – 31.12.2005 shpenzime rikonstruksioni në shumën 1,668,540 lekë<sup>36</sup>.

<sup>32</sup> Notë transkriptimi nr. \*\*\* prot., datë 21.8.1936, nga e cila rezulton se shtetasi B.G (gjyshi nga nëna i subjektit) ka blerë nga shtetasi S.G, pasurinë shtëpi... kundrejt vlerës 500 franga ari.

<sup>33</sup> Akt dhurimi datë 30.10.1992, shtetasja P. S (nëna e subjektit) i dhuron shtetasit H. Sinani (të birit) 1/2 pjesë, pjesën veriore të shtëpisë dhe oborrin përkatës, të ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Vlorë. Kjo shtetase pjesën ½ të pasurisë e ka fituar si trashëgimtare e B. G.

<sup>34</sup> Akt dhurimi datë 13.4.1995, shtetasi S. R (vjehëri i subjektit) i dhuron shtetasit Hektor Sinani ½ pjesë të shtëpisë (pjesën jugore), oborrin përkatës dhe një pus uji. Bashkëngjitur vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 13.4.1995.

<sup>35</sup> “29.6.1983 – 28.8.1984 – Nd. Shpendëve Vlorë. 28.8.1984 – 16.3.1988, sekretar gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në periudhën nga viti 1984 e më pas kam pasur gjithmonë depozita kursimi në bankë, ku depozitat kanë qenë me interesa të larta nga 12% deri në 30%. 16.3.1988 – 31.10.1990 – përmbartues gjyqësor. 31.10.1990 avokat në Kolegjin e Avokatëve Vlorë, deri në daljen avokat privat me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.5.1992 (gusht 1991 – kthyer në nëntor 1991, hyrje përsëri në fund të nëntorit 1991, kthim me 1 mars 1992) – të ardhura nga puna në Greqi 1,000,000 dhrahmi, të konvertuara në lekë 1 x 5 = 500,000 lekë. 2.5.1992 – 6.3.2000 – avokat privat. Nga datë 6.3.2000 e në vijim gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë”.

<sup>36</sup> Për të vërtetuar shpenzimet e kryera në këtë pasuri bashkë me deklaratën *Vetting* dhe pranë Komisionit, subjekti ka depozituar fotokopje të situacionit të shpenzimeve për periudhën 1.1.2003 – 31.12.2005, me objekt

**39.10** Komisioni hartoi analizën financiare, duke u mbështetur në vlerën e investimit sipas situacionit<sup>37</sup> dhe deklaramit të subjektit se ai ka kryer vetëm punime të brendshme, rifinitura, arredim, mobilim etj. Analiza financiare e krijimit të kësaj pasurie është paraqitur në tabelën nr. 2, pasuria nr. \*\*\* (trajtuar më lart), ku rezultoi se subjekti ka pamundësi financiare në kryerjen e punimeve të rikonstruksionit të ndërtesës, në vlerën totale të investimeve të kryera prej -1,668,540 lekësh.

**39.11** Komisioni, në përfundim të hetimit i kaloi barrën e provës subjektit, për sa vijon:

- Ka pasaktësi në deklaramet periodike lidhur me origjinën e krijimit të kësaj prone, ku dhurimin e ½ nga vjehri subjekti e deklaroi vetëm në deklaratën *Vetting*, duke penguar vlerësimin e plotë dhe të saktë të burimit të krijimit të kësaj pasurie, në kuptim të ligjit nr. nr. 84/2016.
- Subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të rikonstruktuar banesën gjatë viteve 2000 – 2005, në vlerën totale prej -1,668,540 lekësh.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**39.12** Subjekti i rivlerësimit gjatë prapësimeve është shprehur se kjo pasuri është deklaruar që në deklaramet e para periodike të ILDKPKI-së. Ai ka sqaruar se në këtë banesë të trashëguar nga gjyshi ka banuar pas martesës së vëllait të tij, A.S, të cilën më pas e ka rindërtuar me të ardhurat nga emigracioni në shtetin grek. Vlera e rikonstruksionit prej 1,668,540 lekësh deklaroi se është e mbuluar me të ardhura të ligjshme.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**39.13** Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, shpjegimeve të dhëna me prapësime dhe gjatë seancës dëgjimore, çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë një deklaramit të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me vlerën e investimit të bërë në këtë pasuri. Komisioni, pavarësisht deklarameve të pasakta dhe kontradiktore, ka kryer analizën financiare bazuar në situacionin e punime të vëna në dispozicion, nga ku rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi të realizojë investimet mbi ndërtesë me të ardhura të ligjshme, duke rezultuar në pamundësinë financiare prej -1,668,540 lekësh.

**39.14 Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë se burimet për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë të krijuara në mënyrë të ligjshme, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**40. Apartament me sip. 43.4 m<sup>2</sup>,** pallati nr. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, z. k. \*\*\*, Vlorë, 2+1, regjistruar në Hipotekë me nr. \*\*\*, datë 14.11.1994, me kontratë privatizimi datë 27.5.1993, blerë nga shteti në shumën 10,710 lekë, në bashkëpronësi: sipas përbërjes familjare në dokumentet e dala nga arkivi i ZVRPP-së Vlorë me nr. reference \*\*\*, me bashkëpronar M, Hektor, A, N, L.S, M.S, nëna P. Subjekti dhe bashkëshortja 2/6 pjesë ideale + 1/42 pjesë nga nëna. Pjesa takuese: 20%.

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

---

“Rikonstruksion çatie dhe punime të brendshme, me investitor shtetasin Hektor Sinanaj dhe zbatues shtetasin A.D, në shumën 1,668,540 lekë, si dhe foto të jashtme të papafingos të shtëpisë.

<sup>37</sup> Aneks nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së.

**40.1** Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003.

**40.2** Nga hetimi<sup>38</sup> rezulton se me kontratën e privatizimit datë 27.5.1993 apartamenti është privatizuar nga Ndërmarrja Komunale Banesa Vlorë, e ndërtuar në vitin 1978 në lagjen “\*\*\*\*” nga shtetasi M.S, regjistruar në Hipotekë në datën 14.11.1994.

**40.3** Në kohën e privatizimit të apartamentit, në Gjendjen Civile<sup>39</sup> të regjistruar me kryefamiljarin M.S kanë qenë edhe pjesëtarët e tjerë të familjes Hektor, A, N, L dhe M.S. Nga hetimi nuk rezultuan ndryshime të tjera për pjesët zotëruese pas ndërrimit jetë të prindërve të subjektit të rivlerësimit.

**40.4** Rezultoi se kjo pasuri është krijuar në vitin 1992, para fillimit të detyrës nga privatizimi i banesave shtetërore, në bashkëpronësi të të gjithë personave sipas përbërjes familjare që rezultonte në datën 1.12.1992, me shtetasin M.S, pjesë e së cilës janë subjekti dhe bashkëshortja e tij, duke trashëguar secili pjesën takuese. Pasi prindërit e subjektit kanë ndërruar jetë, nuk janë reflektuar ndryshime për sa u përket pjesëve takuese dhe sipas deklaratimit të subjektit kjo pasuri *de facto* i është lënë familjes së vëllait të tij, A.S, i cili ka banuar dhe banon edhe sot në të.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**40.5 Në përfundim**, Komisioni vlerëson se nuk u paraqitën problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me këtë pasuri.

**41. Automjet tip “Mercedes-Benz”**, me targa \*\*\* dhe \*\*\*, blerë në vitin 1995, në shumën 500,000 lekë, nga shtetasi M.R në Durrës, regjistruar në DPSHTRR Vlorë. Shitur më pas me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.5.2008, blerësit A.Y, në shumën 250,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

#### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**41.1** Sipas deklaratimeve të subjektit, ky automjet është blerë në vitin 1995 (para fillimit të detyrës) në vlerën 500,000 lekë nga shtetasi M.R në qytetin e Durrësit, duke mos depozituar kopje të kontratës së blerjes në vitin 1995.

**41.2** Me kontratën e shitjes datë 27.5.2008<sup>40</sup>, subjekti deklaroi se i ka shitur shtetasit A.Y automjetin me targë \*\*\*, në vlerën 250,000 lekë (likuiduar jashtë zyrës noteriale).

**41.3** Nga kopja e vërtetimit datë 24.10.2016, lëshuar nga DPSHTRR-ja (Drejtoria Rajonale Vlorë), vërtetohet se automjeti me targë \*\*\* ka ndërruar pronësi dhe targë në \*\*\* dhe aktualisht figuron me çregjistrim të përhershëm<sup>41</sup>.

---

<sup>38</sup> Kontratë privatizimi datë 27.5.1993, me palë shitëse N. Banesa Vlorë dhe palë blerëse shtetasin M.S, me objekt “Shitjen e një apartamenti 2+1, në shumën 10,710 lekë”. Bashkëngjitur: formulari nr. 3; planimetri; plan vendosje; vërtetim; certifikatë e përbërjes familjare; kërkesë, deklaratë dhe akti i dhënies në dorëzim të banesës (aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>39</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2021.

<sup>40</sup> Kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.5.2008, lidhur midis palës shitëse Hektor Sinanaj dhe palës blerëse A.Y, me objekt “Shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” me targë \*\*\*, kundrejt çmimit 250,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës së noterit. Bashkëngjitur kontratë provizore për sigurimin e mjetit dhe vërtetim për kalim pronësie në favor të blerësit M.R.

<sup>41</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2016, lëshuar nga DRSHTTRR Vlorë, ku konfirmohet se shtetasi Hektor Sinanaj nuk është pronar i automjetit tip “Mercedes-Benz” me targë \*\*\*. Ky automjet ka ndërruar targë (\*\*\*) pronësi dhe

**41.4** DPSHTRR-ja<sup>42</sup> nuk e konfirmon automjetin sa më sipër me targë \*\*\*, ose \*\*\*, në pronësi të shtetasit Hektor Sinanaj (Sinani).

**41.5** Komisioni hetoi<sup>43</sup> lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi dhe iu drejtua Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë nëse nga ana e subjektit të rivlerësimit janë gjykuar çështje gjyqësore ku shtetasit M.R dhe A.Y të kenë qenë pjesëmarrës me çfarëdolloj cilësie në proceset gjyqësore të gjykuara nga subjekti Hektor Sinanaj, nga e cila rezultoi se nuk ka gjykuar çështje të çfarëdolloj cilësie me palë ndërgjyqëse shtetasit e mësipërm.

### **Në lidhje me burimin e ligjshëm**

**41.6** Subjekti në deklaratën *Vetting* deklaroi se burim financiar për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer kursimet nga puna deri në vitin 1995. Subjekti rezultoi me pamundësi financiare për blerjen e automjetit me të ardhura të ligjshme (referojuni tabelës nr. 2 më lart, në trajtimin e pasurisë nr. \*\*\*).

**41.7** Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni konstatoi se ka mospërputhje të vlerës së blerjes së automjetit deklaruar për herë të parë në deklarinimin para fillimit të detyrës në vitin 2003 në ILDKPKI, në vlerën 0.4 milion, me atë të deklaruar në deklaratën *Vetting*, në vlerën 500,000 lekë. Gjithashtu, nga hetimi subjekti rezultoi me pamundësi financiare në vlerën e blerjes së automjetit prej -500,000 lekësh. Subjektit iu kërkuan shpjegime për sa konstatuar gjatë hetimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**41.8** Subjekti në prapësime shpjegoi se mospërputhja mes vlerës 0.4 milion lekë dhe vlerës 0.5 milion lekë është pasqyruar për faktin se për këtë automjet nuk ka gjetur kontratën e shitblerjes të vitit 1995, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nga blerja.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**41.9** Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se pas njohjes së të ardhurave nga avokatia gjatë periudhës shtator 1992 – 1999, analiza financiare e subjektit në këtë periudhë ndryshon, duke rezultuar me burime të ligjshme për krijimin e pasurisë, pasqyruar në tabelën më poshtë:

**Tabela nr. 3**

<b>Vitet</b>	<b>1992 – 1995</b>
Të ardhura nga avokatia shtator 1992 – 1999	4,500,000 lekë
Investime të kryera për ndërtesën 3-katëshe, me adresë lagjja “****”, V****	165,000 lekë
Blerja e automjet tip “Mercedes-Benz”, blerë në vitin 1995, në shumën 500,000 lekë	500,000 lekë
Shpenzime arredimi dhe mobilimi sipas pyetësorit standard	460,000 lekë
Shpenzime jetike (66% e të ardhurave)	2,970,000 lekë
<b>Rezultati financiar</b>	<b>405,000 lekë</b>

figuron me çregjistrim të përhershëm. Bashkëngjitur fatura për pajisjen me vërtetim dhe vërtetimin për heqjen nga qarkullimi.

<sup>42</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2023.

<sup>43</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2023.



**41.10 Në përfundim**, Komisioni vlerëson se për këtë pasuri nuk paraqiten problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**42. Automjet tip “Toyota”**, me targë \*\*\*, blerë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2008, nga pala kredidhënëse T.L, në shumën 23,000 euro, shlyer me këste mujore 357 euro/muaj, për 5 vjet kohë. Pjesa takuese: 100%.

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**42.1** Nga dokumentacioni bashkëlidhur deklaratës rezultoi se në datën 14.5.2008 është lidhur kontrata themelore e qirasë financiare (*leasing*), nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2008, midis palës qiradhënëse, shoqërisë “T.L” sh.a. dhe palës qiramarrëse, shtetasit Hektor Sinanaj, me objekt “Dhënie me qira financiare të një sendi të përzgjedhur nga qiramarrësi”. Në shtojcën nr. 1 bashkëlidhur kontratës, sendi i përzgjedhur është automjeti tip “Toyota Corolla”, ngjyrë gri, me targë \*\*\*. Vlera e sendit të marrë me qira: 24,000 euro<sup>44</sup>.

**42.2** Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar blerjen sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2008, nga pala qiradhënëse T.L, të automjetit tip “Toyota”, me targë \*\*\*.

**42.3** Në vitin 2013, pas pagesës së të gjithë vlerës së detyrimit të kontratës së mësipërme, palët kontraktore (palë shitëse shoqëria “T.L” sh.a. dhe palë blerëse Hektor Sinanaj) në datën 16.3.2013<sup>45</sup> kanë lidhur kontratën e shitblerjes së automjetit ngjyrë gri, me targë \*\*\*, kundrejt çmimit 693 euro, shumë e cila sipas kontratës është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

**42.4** DPSHTRR-ja<sup>46</sup> konfirmon pronësinë e automjetit tip “Toyota” me targë \*\*\* në pronësi të subjektit Hektor Sinanaj.

### **Lidhur me burimin e ligjshëm**

**42.5** Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 pakësim 7,200 euro; gjendje *cash*; kursime 6,500 euro. Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar gjendjen e kursimeve *cash* “*Kursime në lekë, gjithsej 500,000 lekë (kthyer në euro 2,000), të cilat së bashku me gjendjen cash të vitit të kaluar janë depozituar në Raiffeisen Bank. Ndërsa 2,000 euro janë gjendje cash në shtëpi*”, të cilat rezultojnë të pamjaftueshme për krijimin e vlerës 7,200 euro të depozituar *cash* prej tij për blerjen e automjetit. Ndërkohë, në DIPP-në e vitit 2009 deri në vitin 2013 subjekti deklaroi shlyerjen e detyrimit.

**42.6** Në DPV-në e vitit 2021, subjekti deklaroi: “*Automjet... burimi i krijimit: të ardhura 23,000 euro. Burimi i fondeve janë kursime familjare dhe hua nga shtetasi Z.N.J.G në vlerën*

---

<sup>44</sup> Sipas kontratës, vlera përfundimtare e sendit të marrë me qira, që përbën edhe bazën e përlogaritjes së pagesave të qirasë, përcaktohet pas përfundimit të procedurës së marrjes së tyre, në bazë të shumës së shpenzimeve që ka bërë qiradhënësi për fitimin e tyre. Qiraja e parë e barabartë me 30% të vlerës përfundimtare të sendit është paguar në vitin 2008, ndërsa qiratë në vijim do të paguhën duke filluar nga data 2.6.2008 në çdo datë 2 të çdo muaji në vazhdim. Të gjitha pagesat sipas kontratës janë bërë në Tirana Bank.

<sup>45</sup> Kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.3.2013, lidhur midis palës shitëse, shoqërisë “T.L” sh.a. dhe palës blerëse, shtetasit Hektor Sinanaj, me objekt “Shitjen e automjetit tip “Toyota Corolla”, gri, me targë \*\*\*, kundrejt çmimit 693 euro”, likuiduar jashtë zyrës noteriale (aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së); vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2016, lëshuar nga DRSHTRR Vlorë, ku konfirmohet se shtetasi Hektor Islamaj (lapsus në shkresë, pasi nga dokumentacioni mbiemri është Sinanaj) është pronar i automjetit “Toyota Corolla” me targë \*\*\*, për këtë automjet ka dorëzuar targat (\*\*\*). Bashkëngjitur leje qarkullimi e nxjerrë nga sistemi elektronik i DPSHTRR-së.

<sup>46</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2023.

4,500 euro dhe 300,000 lekë të përfituar si kthim huaje nga vjehri S.R”. Në këtë deklaratë konstatohet se subjekti ndryshon deklarimin për burimin e krijimit të pagesës *cash* prej 7,200 euro.

**42.7** Nga hetimi rezultoi se subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të dhënies së huas nga shtetasi Z. G, si dhe duke qenë se vlera e marrë nga vjehri, e deklaruar e falur në vitin 2007, nuk deklarohet si kursim i mbartur në vitin 2008, nuk është përfshirë si burim për blerjen e automjetit.

**42.8** Nga analiza financiare e Komisionit rezultoi se në vitin 2008, i cili është me vlerë negative, subjekti nuk kishte mundësi të krijonte pasurinë e mësipërme dhe të shlyente këstet e qirasë financiare (*leasing*).

**42.9** Komisioni në përfundim të hetimit i kaloi barrën e provës subjektit, për sa vijon:

- Ka mospërputhje të vlerës së deklaruar 23,000 euro me vlerën 24,000 euro në kontratë dhe vlerën e shpenzimeve përfundimtare 30,581 euro.
- Subjekti rezultoi me pamundësi në krijimin e pasurisë së mësipërme për të gjithë vlerën e blerjes së tij prej -24,000 euro.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**42.10** Subjekti i rivlerësimit, gjatë prapësimeve nuk është shprehur në lidhje me barrën e provës të lënë nga Komisioni për pamundësinë e krijimit të pasurisë sa më sipër.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**42.11** Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë një deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e blerjes së automjetit.

**42.12 Në përfundim**, Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë se burimet për krijimin e të kësaj pasurie kanë qenë të krijuara në mënyrë të ligjshme, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**43. Automjet tip “Volkswagen Golf”**, me targë \*\*\*, leje qarkullimi nr. \*\*\*, blerë nga shitësi B.H, me kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.7.2013, në shumën 3,500 euro. Burimi i krijimit: kursime familjare. Pjesa takuese: 100%.

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**43.1** Nga hetimi<sup>47</sup> rezultoi se me kontratën e shitblerjes datë 30.7.2013 subjekti ka blerë nga shtetasi B.A.H automjetin tip “Volkswagen”, vit prodhimi 2004, në vlerën 3,500 euro. Në deklaratë palët deklarojnë se janë likuiduar mes tyre për këtë shumë dhe se nuk kanë asnjë lloj detyrimi.

**43.2** DPSHTRR-ja<sup>48</sup> konfirmon se subjekti Hektor Sinanaj ka pasur në pronësi automjetin me targë \*\*\*. Nga aktet në dosje rezultoi se nga akti i shitjes, përpiluar në shtetin gjerman para blerjes nga subjekti, vlera e automjetit nga shtetasi B.H ka qenë 1,300 euro (detyrimet doganore në vlerën 40,619 lekë).

<sup>47</sup> Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.7.2013, lidhur midis palës shitëse B.H dhe palës blerëse Hektor Sinanaj, me objekt “Shitjen e automjetit tip “Volkswagen Golf”, kundrejt çmimit 3.500 euro”, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

<sup>48</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2023.

**43.3** Komisioni hetoi<sup>49</sup> në lidhje me ekzistencën e një konflikti të mundshëm interesi me shitësin e mjetit B.A.H, nga ku rezultoi se gjatë kohës së ushtrimit të detyrës së gjyqtarit subjekti nuk ka gjykuar çështje të çfarëdolloj cilësie, ku palë ndërgjyqëse të ketë qenë shtetasi B.A.H.

#### **Lidhur me burimin e ligjshëm**

**43.4** Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se burim të krijimit kanë shërbyer kursimet familjare. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare të krijojë me të ardhura të ligjshme pasurinë e mësipërme gjatë vitit 2013, duke qenë se rezultati financiar i vitit 2013 është negativ, në vlerën -3,153,000 lekë. Për pamundësinë financiare, subjektit i kaloi barra e provës.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**43.5** Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se kjo pasuri është deklaruar në deklaratën e vitit 2013, pasuri e cila është verifikuar edhe nga kontrolli i ILDKPKI-së, ku burimi i të ardhurave është deklaruar nga kursimet familjare. Kjo pasuri ka qenë e mundur të mbulohet nga të ardhurat e krijuara në mënyrë të ligjshme si paga, aktiviteti biznes i bashkëshortes dhe qiradhëniet.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**43.6 Në përfundim**, Komisioni vlerëson se subjekti rezulton me pamundësi financiare për të krijuar pasurinë sa më sipër me të ardhura të ligjshme gjatë vitit 2013, në vlerën totale të blerjes së automjetit prej -3,500 euro.

#### **44. Subjekti deklaron në deklaratën e pasurisë, si vijon:**

**44.1 Depozitë në lekë, në shumën 1,000,000 lekë**, në Bankën Amerikane të Investimeve, me afat 1 vit, 21.6.2016 – 21.6.2017, me 0.60% interes. Pjesa takuese: 100%.

**44.2 Depozitë në shumën 10,000 euro**, në Bankën Amerikane të Investimeve, me afat 1 vit, 29.3.2016 – 29.3.2017, me interes 0.60%. Pjesa takuese: 100%.

**44.3 Depozitë në shumën 20,000 euro**, në Bankën Amerikane të Investimeve, me afat 1 vit, 2.11.2016 – 2.11.2017, me interes vjetor 0.30%. Pjesa takuese: 100%.

**44.4 Depozitë në shumën 2,500,000 lekë** në BKT, me afat 1 vit, 24.3.2016 – 24.3.2017, me interes 1%. Pjesa takuese: 100%<sup>50</sup>.

**44.5 Llogari bankare në euro pranë Tirana Bank**, me nr. \*\*\*, në shumën 10,000 euro. Aktualisht gjendje 5,000 euro. Këtë llogari subjekti deklaron se e ka hapur për transferim të kontributeve nga kursimet familjare – gjendje *cash*, për djalin J.S, student mjekësie në Gjermani. Pjesa takuese: 100%.

**44.6** Burimi i krijimit të depozitave dhe llogarisë bankare (si më lart) janë krijuar nga: të ardhurat nga paga si gjyqtar, biznesi i bashkëshortes L.S, kopshti “\*\*\*\*”, me NIPT \*\*\*, në administrim nga bashkëshortja dhe dhënie me qira të ambienteve të pasurive të paluajtshme të deklaruara, bashkëngjitur këtij formulari, kontratat e qirasë; pakësimi i depozitave; kontratat e qirasë së ambienteve tri vitet e fundit, të cilat pas daljes së VKM-së janë bërë noteriale e futur

<sup>49</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2023.

<sup>50</sup> Subjekti deklaron në deklaratën *Vetting* edhe: depozitat si më lart (paragraf 38) më parë janë kontraktuar e rifreskuar çdo vit në Raiffeisen Bank, Emporiki Bank, Credit Agricole, aktualisht Banka Amerikane e Investimeve. Bashkëngjitur gjenden aktet provuese në inventarin e dokumenteve. Këto depozita janë deklaruar çdo vit në ILDKPKI.

në sistem, për efekt të tatimit në burim mbi të ardhurat nga qiraja, që sipas ligjit paguhen nga qiramarrësi, ndërsa qiradhënësi e llogarit paraprakisht në çmimin e kontratës.

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**44.7** Subjekti ka deklaruar krijimin e pasurive sa sipër në deklaratat periodike të vitit 2007 e në vijim me shtesat/ndryshimet e tyre në sistemin bankar.

**44.8** Raiffeisen Bank<sup>51</sup>, Tirana Bank<sup>52</sup>, BKT dhe ABI Bank<sup>53</sup> konfirmojnë se z. Hektor Sinanaj është klient i tyre dhe përputhet deklarimi i tij me sa rezultuar nga informacioni i përcjellë prej tyre.

**44.9** Ndërsa në lidhje me burimin e ligjshëm, Komisioni konstaton se analiza financiare e viteve 2000 – 2016 e subjektit të rivlerësimit rezulton me vlerë negative për çdo vit të saj. Për ekonomi gjyqësore për këto pasuri nuk do të hartohet analizë financiare e burimit të krijimit, pasi edhe ajo do të rezultonte me vlerë negative, ashtu si edhe analiza gjithëpërfshirëse e viteve 2003 – 2016.

**44.10** Në lidhje me sa më sipër, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për krijimin e këtyre depozitave me burime të ligjshme. Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**44.11** Subjekti i rivlerësimit, gjatë prapësimeve është shprehur se në vlerësimin për justifikimin e këtyre pasurive me burimin e ligjshëm duhet të merren në konsideratë në rivlerësimin të analizës financiare të Komisionit edhe të ardhurat e tjera të panjohura prej Komisionit deri tani, për të cilat shprehet se ka sjellë edhe prova të reja dhe shpjegimet përkatëse.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**44.12** Komisioni, pas analizimit të provave dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti me prapësime dhe gjatë seancës dëgjimore, të cilat janë trajtuar gjerësisht në pasuritë e mësipërme, në përfundim vlerëson se subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka pasur mundësi për krijimin e këtyre depozitave me burime të ligjshme.

**45. Gjendje kursimesh cash në deklaratën Vetting**, diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si më sipër në këtë deklaram, gjendjet në sistemin bankar. Subjekti ka deklaruar: *“Kam cash unë dhe bashkëshortja deri në dorëzimin e kësaj deklarate shumat 8,000 euro e 300,000 lekë<sup>54</sup>”*.

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

---

<sup>51</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2021.

<sup>52</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2023.

<sup>53</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2021.

<sup>54</sup> Subjekti vazhdon deklarinin në deklaratën Vetting: *“Sqaroj se kam mbajtur cash më parë unë dhe bashkëshortja në disa raste deri në 3,000,000 (pasi në zbatim të ligjit secili ka të drejtat të barabarta të mbajë deri në 1,500,000), pasi kam pasur vazhdimisht pagesa cash për ndërtimet, si dhe për faktin se në vitin 2002 e më pas bankat rrezikoheshin të falimentonin, si dhe pagesat nga qiramarrësit janë paguar cash, sepse nuk i paguanin në bankë. Bashkëshortja që ka administruar si qiradhënëse, me vështirësi i ka mbledhur edhe cash, në lekë dhe në valutë – euro”*.

**45.1** Në deklaratat periodike në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar në lidhje me gjendjet *cash* gjatë periudhës 2003 – 2016 dhe të ardhurat nga gjendja *cash* e kursimeve<sup>55</sup>.

**45.2** Komisioni, pas analizimit të deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike, konstaton se ai deklaroi gjendje kursimesh *cash* dhe jo shtesa apo pakësime të tyre. Në vijim janë paraqitur gjendjet *cash* të kursimeve të përfshira në analizën e Komisionit, si më poshtë:

**Tabela nr. 4** (vlerat në lekë)

Vitet	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Gjendja e kursimeve <i>cash</i>	700,000	700,000	716,650	668,360	241,820	800,686	469,900	902,265	1,244,700	978,040

Vitet	2013	2014	2015	2016	Dek. Vetting
Gjendja e kursimeve <i>cash</i>	2,944,410	3,684,560	4,116,550	1,382,160	1,363,600

**45.3** Nga analiza financiare rezultoi se deklarimi i gjendjes së kursimeve *cash* në deklaratën *Vetting* përputhet me deklaratimet periodike të subjektit.

**45.4** Ndërsa në lidhje me burimin e krijimit të tyre, Komisioni vëren se analiza financiare e viteve 2003 – 2016 rezultoi me vlerë negative për të gjithë periudhën e krijimit të këtyre gjendjeve *cash*. Pra, subjekti nuk ka pasur mundësi të krijojë me të ardhura të ligjshme gjendjet *cash* të kursimeve 2003 – 2016. Sa më sipër, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare në krijimin e gjendjeve *cash* të kursimeve në periudhën 2003 – 2016 dhe i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**45.5** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar me prapësimet dhe në seancën dëgjimore se mosnjohja e pasurive të krijuara në mënyrë të ligjshme me të ardhurat nga avokatia dhe nga qiradhënia kanë sjellë si pasojë rezultatin e një analize financiare që duhet të rishikohet nga Komisioni.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

<sup>55</sup> Në DPV/2003, subjekti ka deklaruar gjendjen *cash* të shumës 0.7 milion lekë, me burim punën 7 muaj në emigracion (Greqi); të ardhura nga puna 10 vjet si avokat dhe 4 vjet si gjyqtar. Në DPV/2004 ka deklaruar gjendjen *cash* 700,000 lekë, të mbledhura nga viti 2003, kthim huaje nga vëllai dhe vjehri 700,000 lekë. Në DPV/2005 ka deklaruar gjendjen në likuiditet të mbetur nga kredia e marrë + kursime 2005, në vlerën 5,000 USD + 200,000 lekë. Në DPV/2007 deklaroi kursime në lekë, gjithsej 500,000 lekë (kthyer në euro 2,000), të cilat së bashku me gjendjen *cash* të vitit të kaluar janë depozituar në Raiffeisen Bank, ndërsa 2,000 euro janë gjendje *cash* në shtëpi. Në DPV/2008 deklaroi gjendjen *cash* kursime, vlerën 6,500 euro. Në DPV/2009 deklaroi gjendjen *cash* kursime, vlerën 5,000 USD. Në DPV/2010 deklaroi gjendjen *cash* kursime në datën 31.12.2010, vlerën 6,500 euro. Në DPV/2011 deklaroi gjendjen *cash* kursime në datën 31.12.2011, vlerën 9,000 euro. Te seksioni i të ardhurave deklaroi “Të ardhura nga kursimet e vitit 2011 – gjendje *cash* – 9,000 euro”. Në DPV/2012, te seksioni i pasurisë, deklaroi “Gjendje *cash* kursime në datën 31.12.2012, 7,000 euro”. Te seksioni i të ardhurave deklaroi “Të ardhura nga kursimet gjendje *cash* – 7,000 euro”. Në DPV/2013 – te seksioni i pasurisë – deklaroi “Gjendje *cash* kursime në datën 31.12.2013, 21,000 euro”. Te seksioni i të ardhurave deklaroi “Të ardhura nga kursimet gjendje *cash* të vitit 2012, në shumën 7,000 euro”. Në DPV/2014 – te seksioni i pasurisë – deklaroi “Gjendje *cash* kursime në datën 31.12.2014, 8,000 euro, 1,200,000 lekë, 12,000 USD”. Te seksioni i të ardhurave deklaroi “Të ardhura nga gjendja *cash*, kursime të vitit 2013, të deklaruara në formularin e vitit 2014 shuma 21,000 euro”. Në DPV/2015 – te seksioni i pasurisë – deklaroi “Gjendje *cash* kursime në datën 31.12.2015, 27,000 euro dhe 400,000 lekë”. Te seksioni i të ardhurave deklaroi “Të ardhura nga gjendja *cash*, kursime të vitit 2014, të deklaruara në formularin e vitit 2015 shumat 8,000 euro, 1,200,000 lekë dhe 12,000 USD”. Në DPV/2016 – te seksioni i të ardhurave deklaroi “Të ardhura nga konsumimi i gjendjes *cash* më 31.12.2015 (të tij dhe të bashkëshortes), deklaruar në formularin e vitit 2016. Mbetur gjendje *cash* më 31.12.2016 shumat 8,000 euro dhe 300,000 lekë.

**45.6 Në përfundim,** Komisioni vlerëson se ka pamundësi financiare në krijimin e gjendjeve *cash* të kursimeve të deklaruara në periudhën 2003 – 2016.

### **DEKLARIMET E PERSONIT TË LIDHUR/BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT, ZNJ. L.S**

**46.** Të ardhura nga biznesi që kryen bashkëshortja L.S – aktivitet të arsimit fillor për vitet 2008 – 2016, me NIPT \*\*\*, sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2016, të Drejtorisë Tatimore Vlorë dhe faturës së kasës 2016 janë gjithsej të ardhurat neto në shumën 12,704,858 lekë.

**46.1** ISSH-ja<sup>56</sup> konfirmon të ardhura nga vetëpunësimi për periudhën janar 2012 – shtator 2020.

**46.2** DPT-ja<sup>57</sup> dhe DRT Vlorë<sup>58</sup> konfirmojnë se znj.L.S.S rezulton administratore e subjektit “L.S”, me NIPT \*\*\* Bashkëlidhur me shkresën e tyre përcillen të ardhurat dhe fitimi i deklaruar për këtë subjekt tregtar, të pasqyruara në tabelën më poshtë:

**Tabela nr. 5** (vlerat në lekë)

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Të ardhurat</b>	2,310,000	1,985,000	780,000	1,990,000	1,960,000	621,780	240,000	1,402,328	1,442,750
<b>Fitimi</b>	443,509	522,718	490,796	628,451	533,703	524,702	86,779	1,100,000	847,410

**46.3** Rezultoi se totali i të ardhurave për të gjithë periudhën e mësipërme është 5,178,000 lekë. Komisioni ka përfshirë në analizën e tij financiare vlerën e fitimit të konfirmuar nga shkresa e DRT Vlorë.

### **DEKLARIMET E PERSONIT TË LIDHUR/DJALIT TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT, Z. S.S**

**47.** Djali i subjektit të rivlerësimit, z. S.S, ka deklaruar: *“Kam punuar si jurist pranë zyrës së përmbarimit “\*\*\*”, me NIPT \*\*\*, në periudhën 2.10.2015 – 31.3.2016, paguar me një pagë mujore 22,000 lekë dhe pagë neto 19,536 lekë. Janë paguar kontributet shoqërore e shëndetësore. Në llogarinë time kanë kaluar nga prindërit e mi shumat 150,000 lekë në datën 9.6.2016 dhe 20,000 lekë më 30.5.2016. Kam tërhequr për nevoja ushqimi e studimi, sipas veprimeve bankare që jua paraqes bashkëngjitur kësaj deklaratë datë 20.10.2016. Të ardhurat nga paga ime janë në shumën 117,216 lekë, pjesa takuese 100%. Të ardhura nga paga si jurist në zyrën e përmbarimit “\*\*\*”, të ardhura veçmas, gjithsej 117.216 lekë. Kaluar në llogarinë time në Raiffeisen Bank me nr. \*\*\* nga prindërit e mi shumat 20,000 lekë në datën 30.5.2016 dhe 150.000 lekë në datën 9.6.2016”.*

**47.1** Konfirmohet marrëdhënia e punësimit dhe të ardhurat prej saj nga shkresa e ISSH-së<sup>59</sup>.

**47.2** Gjithashtu, nga përgjigjja e Raiffeisen Bank<sup>60</sup> konfirmohen depozitimet e realizuara në llogarinë e shtetasit S.S gjatë vitit 2016. Vlerat e konfirmuara janë përfshirë si shpenzime për mbulimin e shpenzimeve jetike në analizën e Komisionit.

<sup>56</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2021.

<sup>57</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2021.

<sup>58</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2023.

<sup>59</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2021. Vlera e të ardhurave e përfshirë në analizën financiare është 114,552 lekë për vitet 2015 – 2016, kaluar në llogarinë e tij pranë Tirana Bank, sipas *statement*-it të Tirana Bank, aneks nr. 4/12.

<sup>60</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2021, të Raiffeisen Bank.

**47.3** Sa më sipër, Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i personit të lidhur me përgjigjet e ardhura nga institucionet bankare.

## **DEKLARIMET E PERSONIT TË LIDHUR/DJALIT TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT, Z. J.S**

**48.** Djali i subjektit të rivlerësimit, z. J.S, ka deklaruar: “*Llogaria rrjedhëse në emrin tim, konto nr. \*\*\* në bankën gjermane Deutsche Bank, hapur në gusht 2014. Shumë e ngurtësuar për studime transferuar nga Tirana Bank datë 26.8.2014, nga llogaria e babait tim Hektor Sinanaj tek llogaria ime 8,040 euro, pjesa takuese 100%<sup>61</sup>”.*

**48.1** Komisioni analizoi deklaratimet e subjektit dhe personave të lidhur gjatë viteve 2014 – 2016, për të hetuar dhe saktësuar deklaratimet e shtetasit J.S në deklaratën e pasurisë<sup>62</sup>.

**48.2** Komisioni konfirmon vlerat e transfertave bankare nga llogaria e subjektit në Tirana Bank<sup>63</sup> prej gushtit të vitit 2014 deri në dhjetor 2016, të cilat duket se janë transfera jashtë vendit (*international*).

**48.3** Ndërsa nuk përcillen prova nga Deutsche Bank dhe prova për të ardhurat e përfituara nga puna në shtetin gjerman prej shtetasit J.S.

**48.4** Sa më lart, në analizën financiare të Komisionit janë përfshirë shpenzimet sipas deklaratimeve të subjektit dhe djalit të tij, por në mungesë të provave për të ardhurat nuk janë përfshirë të ardhura të tij të fituara jashtë Shqipërisë.

---

<sup>61</sup> Personi i lidhur vazhdon me deklarinimin e tij në deklaratën *Vetting*: “*Pagesa e shkollës E. Institute Berlin për studim dhe qira banese transferuar nga Tirana Bank nga llogaria e babait tim Hektor Sinanaj, 10.508 euro, pjesa takuese 100%. Gjendje 1 janar 2015 në llogarinë rrjedhëse në emrin tim, konto nr. \*\*\* në bankën gjermane Deutsche Bank, në shumën 7.443,86 euro, pjesa takuese 100%. Pagesa e shkollës së E. Institute Berlin për qira banese transferuar nga Tirana Bank nga llogaria e babait tim Hektor Sinanaj, datë 1.4.2015, në shumën 1.571 euro, pjesa takuese 100%. Dërguar nga llogaria e babait tim Hektor Sinanaj në Tirana Bank në llogarinë time datë 26.1.2015 në Deutsche Bank, konto nr. \*\*\*, shuma 1.000 euro – plotësim i shumës për garanci financiare për studime e qëndrim në Gjermani, pjesa takuese 100%. Gjendja në 1 janar 2016 në llogarinë rrjedhëse në emrin tim, konto nr. \*\*\* në bankën gjermane Deutsche Bank, në shumën 3.445 euro, pjesa takuese 100%. Dërguar nga llogaria e babait tim Hektor Sinanaj në Tirana Bank, në llogarinë time datë 10.3.2016 në Deutsche Bank, konto nr. \*\*\*, shuma 3.990 euro, pjesa takuese 100%. Dërguar nga llogaria e babait tim Hektor Sinanaj në Tirana Bank, në llogarinë time datë 2.12.2016 në Deutsche Bank, konto nr. \*\*\*, shuma 5.000 euro, pjesa takuese 100%. Shpenzime për ushqim, arsim, qira banese, transport, palestër sportive, siguracion shëndetësor nga llogaria ime konto nr. \*\*\*, në hapësirën kohore 26.8.2014 – 31.12.2016, në shumën 11.081,08 euro, pjesa takuese 100%. Shpenzime të tjera (cash) për libra, aplikime në universitet dhe ushqim, në shumën 1.050 euro, pjesa takuese 100%. Gjendja në ditën e plotësimit të formularit 31.12.2016 në llogarinë rrjedhëse në emrin tim, konto nr. \*\*\*, në shumën 6.715,56 euro, pjesa takuese 100%”.*

<sup>62</sup> Në DPV/2014, subjekti ka deklaruar: “*Pagesa e shkollës dhe ngurtësim shume për studime të djalit J.S në U. Institute Berlin Gjermani dhe Deutche Bank Gjermani, transferuar shuma nga llogaria ime në Tirana Bank (në shumat 10,508 euro dhe 8,040 euro për ngurtësim në Deutche Bank)*”. Në këtë vit personi lidhur ka deklaruar: llogari rrjedhëse në emirin e tij në Deuche Bank, Berlin, Gjermani dhe sa më sipër të deklaruara të deklarata e subjektit. Në DPV/2015 – pagesa për shkollimin e djalit J.S në Gjermani, transferuar nga llogaria në Tirana Bank, 1,571 euro, për qira banese 1,000 euro dhe pagesë avioni 400 euro. Në deklarinimin si person i lidhur, J.S deklaroi edhe një herë sa më sipër dhe gjendje të llogarisë datë 1.1.2015, në vlerën 7,443.86 euro, si dhe të ardhura nga puna si punëtor në supermarket, firma \*\*\* Berlin – 380 euro (shpenzime vjetore 4,999.35 euro). Në DPV/2016 – dërguar djalit J.S– student në Gjermani në vitin 2016 nga llogaria në Tirana Bank, shuma 9,990 euro. Të ardhura nga djali J.S (kthyer për mosshkaktim dëmi në banesë – shumë e paguar më parë) 300 euro. Në deklarinimin si person i lidhur, J.S deklaroi edhe një herë sa më sipër, duke shtuar gjendjen në llogari rrjedhëse në datën e plotësimit të deklarimit shumën 6,715.56 euro, shpenzime 5,730 euro dhe 300 euro të ardhura nga prindërit.

<sup>63</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.3.2021, të Tirana Bank.

## **DEKLARIMET E PERSONIT TË LIDHUR/VAJZËS SË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT, ZNJ. H.S**

**49.** Vajza e subjektit të rivlerësimit, znj. H.S, ka deklaruar: *“Llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank, me nr. reference \*\*\*, çelur në datën 14.10.2010 dhe mbyllur në datën 30.10.2015. Shuma gjithsej 500,000 lekë, dërguar nga prindërit e mi, tërhequr nga ana ime për studime e ushqim<sup>64</sup>”*.

**49.1** Konfirmohen vlerat e deklaruara nga personi i lidhur H.S nga përgjigjja e Raiffeisen Bank<sup>65</sup>, të dhënat e të cilave janë përfshirë në analizën financiare të Komisionit si shpenzime për mbulimin e shpenzimeve jetike të saj.

### **50. ANALIZA FINANCIARE MARS 2000 – 2016**

**50.1** Komisioni, bazuar në metodologjinë<sup>66</sup> e miratuar dhe në analizë të qëndrimit përfundimtar lidhur me të ardhurat e deklaruara si burim të krijimit të pasurive, hartoi analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003 – 2016, e cila rezultoi me pamundësi financiare në vlerën -26,527,843 lekë për krijimin e pasurive, kryerjen e shpenzimeve, shlyerjen e detyrimeve financiare dhe për krijimin e likuiditeteve. Gjithashtu, edhe analiza financiare nga marrja e detyrës në mars të vitit 2000 deri në deklarimin e parë dhjetor 2002 rezulton me pamundësi financiare në vlerën -6,179,543 lekë.

**50.2** Subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**50.3** Subjekti parashtroi argumente dhe prova, të cilat janë analizuar në këtë vendim në analizën e burimit të krijimit të pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting*.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**50.4** Subjekti i rivlerësimit, gjatë prapësimeve dhe seancës dëgjimore është shprehur se analiza financiare e përgatitur nga Komisionit duhet të rishikohet për arsytet se nuk janë përfshirë një sërë të ardhurash për të cilat, edhe pse datojnë nga një periudhë e largët, provohet tërësisht ligjshmëria e tyre.

**50.5** Sipas subjektit, duhet të njihen të ardhurat e fituara nga gjendja e depozituar në llogari depozite pranë Bankës së Kursimeve në datën 8.5.2000, shuma fillestare e depozitës 1,000,000 lekë; duhet të njihen të ardhurat e fituara nga emigracioni për një periudhë 7-mujore në shtetin grek, në vlerën totale 1,500,000 dhrahmi greke ose rreth 470,667 lekë; të merren parasysh deklaratimet e dhëna nga familja T me fakte historike të emigracionit të njohur botërisht të popullit shqiptar me mikpritjen e popullit grek; duhet të njihen të ardhurat nga dhënia me qira e subjekteve të deklaruara në pyetësonin standard<sup>67</sup>; duhet të njihen të ardhurat kumulative të

---

<sup>64</sup> Personi i lidhur vazhdon me deklarimin e tij në deklaratën *Vetting*: *“Bashkëngjitur keni si provë të dokumentuar nga Raiffeisen Bank dokument lëshuar në datën 20.10.2016. Këto shuma dhe të tjera të dërguara nga prindërit janë deklaruar nga babai im Hektor Sinanaj në deklaratat periodike të mëparshme, si dhe kam firmosur dhe unë si person i lidhur (tashmë e martuar nga data 16.5.2016, shumat e shënuara ku përfshiheshin edhe ato të kësaj llogarie rrjedhëse”*.

<sup>65</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 21.6.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2021, të Raiffeisen Bank.

<sup>66</sup> Për më tepër referojuni rezultateve të hetimit.

<sup>67</sup> Në periudhën 2000 – 2003 janë përfituar të ardhura nga qiradhënia nga avokat L.XH dhe avokat XH.P. Këta shtetas kanë ndërruar jetë. Sigurohemi për vërtetësinë e faktit të qiramarrjes në atë kohë me të dhënat se në deklaratën e vitit 2003 janë dokumentuar të ardhurat në total dhe kanë përfshirë edhe qiratë e paguara prej tyre. Në pamundësi për ta provuar në mënyrë shkresore marrëdhënien e qirasë, në dispozicion vendosim deklaratën



përfituara nga aktiviteti i avokatisë për periudhën 1992 – 1999, të deklaruara në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarimin e pasurisë për vitin 2003 në shumën 13,800,000 lekë.

**50.6** Subjekti shprehet gjithashtu se nga dokumentacioni që ka paraqitur në Komision deklarohet se ka ushtruar aktivitetin profesional “Avokat” nga viti 1992, bazuar në vendimin nr. \*\*\*, datë 2.5.1992, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe se ky aktivitet është regjistruar në DRT Vlorë me kodin fiskal nr. \*\*\*, me status “person fizik”.

**50.7** Subjekti ka bashkëlidhur me prapësimet analizën financiare të tij dhe shpjegon se të ardhurat e deklaruara prej tij për shkak të natyrës së aktivitetit të avokatisë kanë një marzh të lartë fitimi. Gjithashtu, ai kërkon të llogariten edhe huat e dy të afërme të tij, konkretisht shtetasit A.S në vlerën 400,000 lekë dhe shtetasit S.R në vlerën 300,000 lekë.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**50.8** Komisioni çmon se në përputhje me arsyetimin e bërë në këtë vendim, subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të pasurive të krijuara prej tij dhe personave të lidhur, duke mos arritur të përmbysë barrën e provës të kaluar nga Komisioni dhe duke vazhduar të ketë pamundësinë financiare në vlerën -26,527,843 lekë, për periudhën 2003 – 2016.

**50.9** Për analizën financiare të periudhës mars 2000 – 2002, në vijim të arsyetimit të bërë më lart në këtë vendim përfshiu të ardhura nga avokatia me marzh fitimi 90% për periudhën shtator 1992 – 1999, të llogaritura në vlerën totale 13,500,000 lekë, të cilat reduktojnë pamundësinë financiare të subjektit për këtë periudhë në vlerën -2,374,543 lekë.

### **Konkluzion përfundimtar për kriterin e pasurisë**

**51.** Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë, si vijon:

- i. Subjekti nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare në vlerën totale -28,902,386 lekë për krijimin e pasurive, si dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të tij.
- iii. Subjekti nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të tij dhe personave të lidhur.
- iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Hektor Sinanaj nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

---

noteriale të av. A.D për të provuar marrëdhënien e qirasë mes av. L.XH dhe av. XH.P. Kemi vënë në dispozicion për vitet 2003 e më tej deklaratën e kolegut të tyre, z. Y.H, që ka mbajtur zyrë me qira në të njëjtën godinë. Në periudhën prill 2003 – 5.4.2004 janë përfiturar të ardhura nga dhënia e zyrave me qira pranë godinës në rrugën “\*\*\*” me pagesë 15,000 lekë/muaj nga Y.H. Në këtë periudhë ka ushtruar aktivitetin edhe pranë këtyre zyrave edhe avokati L.XH, duke paguar shumën 15,000 lekë/muaj. Në periudhën 5.6.2003 – 5.4.2004 janë përfiturar të ardhura nga shfrytëzimi i ambienteve të godinës me pagesë mujore 30,000 lekë nga A.S, i cili ka shfrytëzuar ambientin për bar-bilardo.

## ANALIZA FINANCIARE MARS 2000 – 2016

Përshkrimi	Para fillimit të deklarimit	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>6,649,083</b>	<b>3,367,041</b>	<b>2,033,708</b>	<b>2,440,355</b>	<b>940,653</b>	<b>708,861</b>	<b>2,533,573</b>	<b>1,220,141</b>	<b>1,357,839</b>	<b>3,000,487</b>	<b>867,676</b>	<b>3,624,512</b>	<b>1,713,048</b>	<b>(219,234)</b>	<b>(1,719,203)</b>
Shtëpi banimi në një sipërfaqe trualli 162 m <sup>2</sup> , në L. "P" V <sup>o</sup> . Burimi i krijimit: Trashëgimi dhe dhurim. Rikonstruktuar me shpenzimet e kryera deri në dhjetor 2005 vlera e situacionit 1,668,540 lekë	667,416	333,708	333,708	333,708											
Apartament adresa L. "2" V <sup>o</sup> , me sip. 43.4 m <sup>2</sup> , regjistruar në dt. 14.11.1994, me Kontratë Privatizimi datë 27.5.1993, në shumën 10,710 lekë, në bashkëpronësi me prindërit, vëllezërit, subjektin, L <sup>o</sup> S <sup>o</sup> e M <sup>o</sup> S <sup>o</sup> . Subjekti dhe bashkëshortja 2/6 pjesë ideale + 1/42 pjesë nga nëna. Vlera e apartamentit 10,710 lekë, pjesa takuese 20%.															
Ndërtesë 3 kate, me adresë në lagjen B <sup>o</sup> V <sup>o</sup> , e ndërtuar nga fundi i vitit 1992, rikonstruktuar deri në vitin 2006. Vlera gjithsej sipas situacionit për periudhën nga data 1.7.2001 deri në datë 31.3.2006 në shumën 9.194.890 lekë. Përshatuar për ambiente zyra dhe aktivitete të tjera private.	4,831,667	2,333,333	1,700,000	1,233,300	160,000										
Pasuria njësi 60 m <sup>2</sup> dhe truall i njësisë, me certifikatat përkatëse të pronësisë lëshuar datë 8.9.2006. Mbi katin ekzistues, legalizuar shtesë kati, lëshuar Certifikata e pronësisë datë 4.1.2011. Vlera 650.000 lekë, blerë me kontratë dt.14.8.2001. Vlera gjithsej sipas situacionit 1.7.2005-31.3.2006 në shumën 1.645.290 lekë	650,000			834,270	834,270			20,951	12,000	16,000					
Automjet tip Benz me targa V <sup>o</sup> dhe V <sup>o</sup> , blerë në vitin 1995, në shumën 500,000 lekë. Shitur me pas me kontratë dt. 27.5.2008 në shumën 250.000 lekë.	500,000						(250,000)								
Automjet tip Toyota, me targë A <sup>o</sup> . Blerë me kontratën dt. 14.5.2008 nga pala kredidhënëse T* L*, në shumën 23,000 Euro, shlyer me këste mujore 357 euro në muaj, për 5 vjet kohë.							2,956,380								
Automjet tip Volkswagen Golf, me targë A <sup>o</sup> , blerë me Kontratë dt. 30.7.2013, në shumën 3.500 euro, kursime familjare.												490,735			
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë dhe CASH		700,000	0	39,077	-53,617	708,861	-172,807	1,199,190	1,345,839	2,984,487	867,676	3,133,777	1,713,048	-219,234	-1,719,203
Total likuiditete		700,000	700,000	739,077	685,460	1,394,322	1,221,515	2,420,705	3,766,543	6,751,030	7,618,707	10,752,484	12,465,532	12,246,298	10,527,095
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>700,000</b>	<b>(700,000)</b>	<b>1,693,413</b>	<b>(499,335)</b>	<b>(436,071)</b>	<b>1,209,841</b>	<b>(1,131,425)</b>	<b>(808,091)</b>	<b>(573,807)</b>	<b>(576,764)</b>	<b>(247,891)</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Kredi bankare B <sup>o</sup> dt. 13.04.2005 vlera 20,000 usd per rikonstrukcion dyqani ne katin dyte				1,693,413	(499,335)	(436,071)	(468,890)	(488,783)	(178,310)						
Hua marrë në dt. 01.05.2008 shtetasi Z* S* në vlerën 4,500 euro.															
Huadhënia shtetasi A* S* në vlerën 400,000 lekë		400,000	(400,000)												
Huadhënia shtetasi S* R* në vlerën 300,000 lekë		300,000	(300,000)												
Dejryme ndaj T* L* për automjetin e blerë me kontratë dt. 14.05.2008							1,678,731	(642,641)	(629,781)	(573,807)	(576,764)	(247,891)			
<b>PASURI NETO</b>	<b>6,649,083</b>	<b>2,667,041</b>	<b>2,733,708</b>	<b>746,942</b>	<b>1,439,988</b>	<b>1,144,933</b>	<b>1,323,732</b>	<b>2,351,566</b>	<b>2,165,930</b>	<b>3,574,294</b>	<b>1,444,440</b>	<b>3,872,404</b>	<b>1,713,048</b>	<b>(219,234)</b>	<b>(1,719,203)</b>
<b>TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>15,728,520</b>	<b>590,442</b>	<b>806,713</b>	<b>808,295</b>	<b>827,010</b>	<b>1,173,252</b>	<b>1,272,326</b>	<b>1,491,476</b>	<b>1,477,234</b>	<b>1,675,225</b>	<b>1,745,224</b>	<b>1,816,133</b>	<b>1,594,517</b>	<b>2,561,748</b>	<b>2,278,507</b>
Të ardhura nga emigracioni në vlerën 1,200,000 dhrahmi ose 470,667 lekë fituar gjate periudhes 7 mujore ne emigracion															
Të ardhura nga avokatia shtator 1992-1999	13,500,000														
Të ardhura nga vendimi i gjykatës i vitit nr. * dt. 10.05.1996 për kthimin e shumës së dhënë hua me interes për vlerën 1,000,000 Lekë nga shtetasi A* M*:	1,000,000														
Të ardhura nga paga e subjektit pranë gjykatës V*	1,228,520	590,442	806,713	808,295	827,010	873,252	812,114	955,872	986,234	991,180	1,049,940	997,163	1,256,243	1,314,923	1,274,328
Të ardhura nga dhënia me qira të ambienteve në godinën 3 kate															
Të ardhura nga bashkëshortja nga aktiviteti i kopshtit "P**"							443,509	522,718	490,796	628,451	533,703	524,702	86,779	1,100,000	847,410
Të ardhura nga paga e djalit S* S*														55,944	58,608
Dhuratë nga vëhtri i subjektit, shtetasi S* R*						300,000									
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare në A* bank											91,151	182,821	174,755	48,496	55,803
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare							16,703	12,886	204	55,594	70,430	111,447	76,740	42,384	42,358
<b>SHPENZIME</b>	<b>11,453,980</b>	<b>469,820</b>	<b>469,820</b>	<b>633,920</b>	<b>1,302,634</b>	<b>946,331</b>	<b>1,049,666</b>	<b>1,509,823</b>	<b>1,225,614</b>	<b>1,652,804</b>	<b>1,702,364</b>	<b>1,096,823</b>	<b>3,360,514</b>	<b>2,799,158</b>	<b>5,187,069</b>
Shpenzime qeraje për apartamentin në T* deklaruar në vetting															45,000
Shpenzime deklaruar në DIPP 2016, takse mbi të ardhurat nga qiraja, banesa e marre me qera ne T* sipas kontrates dt. 01.10.2016															22,500
Shpenzime shkollimi për fëmijët				86,135	253,849	263,231	282,391	303,066	542,514	378,472	587,914	557,760	1,583,231	408,958	1,070,000
Shpenzime të tjera të deklaruara në DIPP 2016 (shp. Riparimi automjeti, blerje kondicioner, konsum															497,800
Shpenzime arredimi dhe mobilimi sipas pyetësorit standart	460,000				501,000							55,000	43,000		
Shpenzime udhëtimi							84,175	523,657		591,233	695,806	60,991	400,217	152,019	261,747
Shpenzime jetike për djalin në Gj*													84,066	688,181	2,190,021
Shpenzime jetike	10,993,980	469,820	469,820	547,785	547,785	683,100	683,100	683,100	683,100	683,100	418,644	423,072	1,250,000	1,550,000	1,100,000
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>(2,374,543)</b>	<b>(2,546,419)</b>	<b>(2,396,815)</b>	<b>(572,567)</b>	<b>(1,915,611)</b>	<b>(918,012)</b>	<b>(1,101,072)</b>	<b>(2,369,912)</b>	<b>(1,914,309)</b>	<b>(3,551,873)</b>	<b>(1,401,580)</b>	<b>(3,153,093)</b>	<b>(3,479,045)</b>	<b>(18,176)</b>	<b>(1,189,359)</b>

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**52.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.8.2020, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.8.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**53.** Sipas raportit, subjekti i rivlerësimit Hektor Sinanaj: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**54.** AKSIK-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2023, informon se nuk u administruan të dhëna shtesë lidhur me subjektin dhe, si pasojë, nuk ndryshon konstatimi fillestar për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

**55.** Komisioni, në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

**56.** Nga hetimi nuk u gjet ndonjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**57.** Trupi gjykues, në kushtet kur nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk u evidentuan rrethana që mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit Hektor Sinanaj ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**58.** Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjisllacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe aktet e tjera ligjore.

**59.** Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përgatitur raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**60.** Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

**61.** Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit bashkë me 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

**62.** Nga shqyrtimi i të dhënave në dosjen personale për subjektin e rivlerësimit konstatohen:

### **Aftësitë profesionale**

#### *a) Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit, gjyqtari Hektor Sinanaj, shfaq njohuri të pakta në drejtim të interpretimit dhe analizimit të dispozitave ligjore të rasteve të trajtuara si në vendime ashtu edhe në dosje. Konstatohen njohuri të pakta në të drejtën civile, njohuri minimale në të drejtën e punës dhe në të drejtën familjare (Kodi i Familjes). Njeh dhe zbaton deri diku dispozitat mbi zgjidhjen e martesës, pasojat që vijnë pas zgjidhjes lidhur me mbiemrin e bashkëshortes, kujdestarinë e fëmijëve të mitur, detyrimin ushqimor për të mitur, të drejtën e takimit të prindit tjetër me fëmijën etj. Shfaq mangësi në njohjen e ligjit, të drejtën penale, duke treguar njohuri të pakta, si dhe shfaq mangësi në të drejtën procedurale penale.

#### *b) Arsyetimi ligjor*

Nga gjetjet në dokumentet ligjore për periudhën e vlerësimit rezulton se subjekti Hektor Sinanaj shfaq aftësi minimale në arsyetimin ligjor. Pothuajse në të tetë vendimet e kontrolluara shfaqen mangësi të konsiderueshme në arsyetimin e tyre. Përmbajtja e vendimeve nuk është gjithëpërfshirëse, pasi nuk u jepet përgjigje ligjore të gjitha pretendimeve apo prapësimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, sidomos në rastet kur gjyqtari i konsideron të papranueshme dhe vendos rrëzimin e tyre. Ka mangësi në arsyetim si në vendimet penale ashtu edhe në vendimet civile. Pothuajse nuk analizohen provat, madje ka raste kur ato as nuk citohen.

Në nxjerrjen e konkluzioneve përfundimtare nuk i kushtohet rëndësi analizës së normës ligjore, madje në çështjet civile nuk merret në analizë as baza juridike e padisë, ndërsa në çështjet penale nuk merret në analizë rrezikshmëria shoqërore e veprës apo ajo e të pandehurit dhe nuk sqarohen arsyet e përzgjedhjes nga gjyqtari të llojit apo masës së dënimit në rastet e fajësisë. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara është i dobët. Vendimet e ndërmjetme rrallë shoqërohen me referencë ligjore, ndërsa arsyetim nuk përmbajnë fare.

### **Hetimi i Komisionit**

Pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuar shpjegime, si vijon:

### **63. Lidhur me dokumentin nr. 1, që i përket vendimit gjyqësor penal nr. \*\*\*, datë 27.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë**

**63.1** Gjatë gjykimit të çështjes rezultoi se gjykata ka miratuar kërkesën për gjykim të shkurtuar me miratim edhe të organit të akuzës. Në përfundim të gjykimit, kjo gjykatë ka vendosur “Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit M. R., për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armës luftarake”, parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal dhe për kryerjen e veprës penale “Kanosje” në dëm të shtetasve J. M. dhe A. S., parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, për shkak se nuk provohet që i pandehuri të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata ka urdhëruar lirim të menjëhershëm të të pandehurit M. R. nga IEVP Vlorë, nëse nuk mbahet i ndaluar apo i arrestuar për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale.

**63.2** Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi konstatohet (nga subjekti i rivlerësimit) se i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës kanë pasur pretendime për një akt procedural të administruar si provë në gjykim që ishte “Procesverbali për paraqitjen për njohje” i datës 27.9.2013, të cilët kanë kërkuar pavlefshmërinë e tij. Në faqen 7 të vendimit, gjykata citon: *“Gjykata gjen të bazuara gjithashtu kundërshtimet për procesverbalin “Për paraqitjen për njohje” datë 27.9.2013. Nuk janë respektuar kërkesat e neneve 171 e 172 të Kodit të Procedurës Penale mbi njohjen e personave dhe zhvillimin e saj që e bëjnë të pavlefshme dhe, konkretisht, personi i ftuar për të bërë njohjen nuk ka bërë një përshkrim të personit për të treguar shenjat që mban mend, siç parashikon dispozita, neni 171/1 i Kodit të Procedurës Penale”.*

**63.3** Në rastin në fjalë, Komisioni konstaton se subjekti, por edhe dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues, megjithëse kanë konstatuar se i pandehuri pretendonte pavlefshmëri të një akti procedural të ndodhur në këtë dosje, madje edhe vetë gjykata e ka pranuar këtë pavlefshmëri në arsyetimin e saj, nuk kanë vendosur që të revokonin vendimin për gjykimin e shkurtuar dhe të procedonin me gjykimin e zakonshëm, por kanë vijuar me gjykimin e shkurtuar.

**63.4** Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kërkuar shpjegime lidhur me vendimmarrjen e gjykatës për marrjen në shqyrtim dhe, më pas, pranimin e kërkesës së të pandehurit për vlefshmërinë e një akti procedural, pa revokuar vendimin e gjykimit të shkurtuar, duke cenuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për gjykimin e shkurtuar, nenet 403 dhe 404, si dhe jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**63.5** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti është shprehur se në këtë gjykim qëndron arsyetimi i dhënë nga Komisioni, por ai është shprehur se ka debatuar me iniciativën e tij si kryesues për revokimin e gjykimit të shkurtuar, por shumica e trupës gjyqësore nuk ka qenë dakord me revokimin e gjykimit të shkurtuar. Gjithashtu shpjegon se ky vendim është paraqitur vetë nga ana e subjektit për shkak të arsyetimit të një vendimi që bie ndesh me qëndrimin e akuzës për fajësi dhe gjykata ka argumentuar me një arsyetim ligjor të kundërtën, dhënien e pafajësisë me argumente që përbëjnë një vlerësim për t’u pasur parasysh në jurisprudencë.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**63.6** Në analizë të fakteve dhe provave, shpjegimeve të dhëna nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, trupi gjykues vlerësoi se subjekti gjatë gjykimit të këtij rasti në dhënien e vendimit ka cenuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për gjykimin e shkurtuar, nenet 403 dhe 404, si dhe jurisprudencës unifikuese të Gjykatës së Lartë.

**63.7 Në përfundim**, trupi gjykues vlerësoi se në këtë rast konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

**64. Lidhur me dokumentin nr. 2, vendimin gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 22.2.2016**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt “Pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë, ... anulimin e veprimeve përmbarimore... marrjen e masës provizore të sigurimit të padisë duke pezulluar veprimet përmbarimore”. Në përfundim të këtij gjykimi, gjykata ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

**64.1** Nga hetimi Komisioni konstatoi se për rastin subjekti nuk ka kryer një proces gjykimi bazuar në prova dhe se ka mbyllur procesin e gjykimit mbi një akt ekspertimi me të meta. Në këtë proces, vendimi përfundimtar nuk është i arsyetuar qartë e në mënyrë të kuptueshme, në të mungon analiza e provave dhe argumentimi logjik. Subjekti, në arsyetim, *zgjdhjen e kontratës në mënyrë të njëanshme nga pala e paditur* e konsideron në formën e vetëgjyqësisë, duke ngatërruar kështu konceptet e së drejtës civile me ato të së drejtës penale.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**64.2** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti është shprehur se: “...*është arsyetuar për të gjitha pretendimet e bazuara dhe që kanë sjellë debat gjyqësor. Për sa i përket përdorimit të termave të së drejtës penale në një proces civil, këto terma nuk duhet të shkëputen nga konteksti për t’u krahasuar me terma të ngjashëm në procesin penal. ...Fakti që nuk mohoj se kam përdorur në fjalinë “Vetëgjyqësi”, duhet të përdorja fjalën “Vetëgjykim”...*”.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**64.3** Komisioni vlerëson se argumentet e dhëna nga subjekti lidhur me përdorimin e terminologjisë së gabuar nuk rrëzojnë barrën e provës lidhur me këtë fakt. Nga ana tjetër, subjekti nuk parashtrroi asnjë argument lidhur me konstatimet e tjera gjatë procesit.

**64.4 Në përfundim**, trupi gjykues çmon se nga subjekti konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

**65. Lidhur me dokumentin nr. 3, që i përket vendimit gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 6.4.2016**, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt “Detyrimin e palës së paditur të korigjojë planvendosjen e pronës për sa i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 31.7.2006, KVKKP Qarku Vlorë”. Ndërhyrës kryesor I. M., objekt i padisë së ndërhyrësit kryesor “Kundërshtimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 31.7.2006, të KVKKP Qarku Vlorë, në emër të H. Sh. Detyrimin e njohjes pronar për sipërfaqen 1.160 m<sup>2</sup>, pjesë e sipërfaqes prej 12.300 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\*, datë 18.7.2011, në emër të I. M.”. Në përfundim të gjykimit, subjekti ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit H. Sh., ...Rrëzimin e ndërhyrjes kryesore me paditës I. M., ...”.

**65.1** Në lidhje me këtë vendim, Komisioni konstatoi se në analizën ligjore të vendimit mungon arsyetimi ligjor, qartësia dhe kuptueshmëria. Nuk pasqyrohet nga subjekti baza ligjore e

ndërhyrësit kryesor, si dhe nuk është arsyetuar se përse janë rrëzuar pretendimet e ndërhyrësit kryesor. Subjekti nuk është shprehur për kërkimet përfundimtare të ndërhyrësit kryesor, duke nxjerrë një vendim pa një analizë dhe pa një argumentim logjik të provave, fakteve dhe dispozitave ligjore.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**65.2** Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti, ndër të tjera, është shprehur se: *“Në standardet më të mira të arsyetimeve të gjykatave nuk është e udhës të arsyetohet mbi çdo pretendim të palëve në gjykim, por vetëm në ato pretendime që janë të bazuara në ligj dhe në prova...”*.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**65.3** Komisioni vlerëson se argumentet e dhëna nga subjekti lidhur me arsyetimin e vendimeve mbi pretendimet e palëve nuk janë të bazuara. Nga ana tjetër, subjekti nuk parashtrori asnjë argument lidhur me konstatimet e tjera gjatë procesit.

**65.4 Në përfundim**, trupi gjykues çmon se konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

**66. Lidhur me dosjen nr. 1, që i përket çështjes penale me nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 25.9.2013**, në ngarkim të të pandehurit E. B., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.11.2013.

**66.1** Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin sa më sipër në mungesë të një arsyetimi ligjor të qartë e të kuptueshëm, pa një analizë dhe interpretim logjik, në kundërshtim me nenin 382 të Kodit të Procedurës Penale. Në dispozitivin e vendimit rezulton se gjyqtari ka zbatuar alternativën e dënimit të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal, por në arsyetim nuk e përmend fare këtë dispozitë dhe aq më pak të analizojë përmbajtjen e saj dhe arsyet e zbatimit të saj në rastin konkret.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**66.2** Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti, ndër të tjera, është shprehur se: *“Janë arsyetuar një sërë rrethanash në favor të të pandehurit për të vendosur alternativën e dënimit të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal, pa qenë e nevojshme që kjo dispozitë të citohej në vendim, sepse legjislacioni shqiptar prezumohet i njohur nga të gjithë shtetasit. Konstatimi juaj se përse nuk është arsyetuar moszbatimi i dënimit me gjobë, por është arsyetuar alternativa e dënimit sipas nenit 59 të Kodit Penal, sqaroj se nuk është detyrim i gjykatës të arsyetojë pazbatueshmërinë e secilës mënyrë dënimi, por është detyrim që të argumentojë bazueshmërinë për llojin e dënimit të caktuar...”*.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**66.3** Trupi gjykues vlerësoi se subjekti ka dhënë vendimin sa më sipër në mungesë të një arsyetimi ligjor të qartë e të kuptueshëm, pa një analizë dhe interpretim logjik, në kundërshtim me nenin 382 të Kodit të Procedurës Penale. Gjatë parashtrimeve të tij, subjekti nuk ka dhënë asnjë argument ligjor mbi të cilën të rrëzojë barrën e provës.

**66.4 Në përfundim**, trupi gjykues çmon se konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

**67. Lidhur me dosjen nr. 2, që i përket çështjes penale me nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 6.5.2015** regjistrimi, me objekt “Vleftësimi i ligjshëm i arrestimit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj shtetasit I.P”, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. Vendimi gjyqësor sa më sipër është dhënë nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm.

**67.1** Nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka dhënë asnjë argument në vendimin e tij se përse arrestimi i shtetasit I.P për një vepër që dënohet në maksimum me 3 vjet burgim është kryer në respektim të parashikimit të bërë në nenin 251/1 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti nuk ka bërë analizë të fakteve të provuara në kuadër të “dyshimit të arsyeshëm”, si dhe nuk jep asnjë argument ligjor për të justifikuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, nuk analizon rrezikshmërinë shoqërore të veprës apo edhe të të dyshuarit. Dispozitivi i vendimit nuk përputhet me pjesën përshkruese-arsyetuese të tij. Subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin në mungesë të një arsytimi ligjor të qartë, të kuptueshëm, pa një analizë dhe interpretim logjik, në kundërshtim me nenin 382 të Kodit të Procedurës Penale. Në vendim ka një mangësi të dukshme të analizës së provave dhe fakteve që kanë çuar subjektin në një vendimmarrje të tillë dhe aplikim të dispozitave përkatëse.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**67.2** Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti, ndër të tjera, është shprehur se: *“Vendimi gjyqësor nuk është një punim shkencor për të sqaruar çdo koncept të së drejtës penale, por është një dokument zyrtar që ka si qëllim të argumentojë përfundimet e arritura dhe debatet e zhvilluara në proces, duke shtuar se si gjyqtar zhvilloja mbi 20 seanca në ditë dhe nuk gjeja kohën e nevojshme të zgjatesha me arsyetime të tejzgjatura në një çështje rutinë...”*.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**67.3** Trupi gjykues vlerësoi se subjekti ka dhënë vendimin sa më sipër në mungesë të një arsytimi ligjor të qartë, të kuptueshëm, pa një analizë dhe interpretim logjik, në kundërshtim me nenin 382 të Kodit të Procedurës Penale.

**67.4** Në përfundim, trupi gjykues çmon se konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

#### **68. Lidhur me dosjen nr. 3, që i përket çështjes civile me nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 12.5.2014 regjistrimi**

**68.1** Nga hetimi rezultoi se në këtë dosje nuk ka një shpjegim se përse nuk është caktuar seanca për veprime përgatitore nga gjyqtari. Seancat gjyqësore janë zhvilluar me vonesë dhe shkaku nuk është pasqyruar në procesverbale. Në seancën e datës 19.9.2014, gjykata ka vendosur të shtyjë seancën për të saktësuar adresën e paditësit, edhe pse në seanca të mëparshme ishte sqaruar një fakt i tillë. Procesverbali i datës 14.10.2014 është titulluar “shënim” dhe jo procesverbal. Gjykimi i çështjes ka zgjatur gjithsej 6 muaj e 28 ditë, në intervalin kohor 13.5.2014 – 11.12.2014. Kohëzgjatja e gjykimit është në tejkallim të afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit të Sistemit të Vlerësimit. Gjyqtari ka rrëzuar prapësimin e palës së paditur, pa dhënë asnjë argument ligjor për rrëzimin.

**68.2** Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se avokati A.D, nga viti 2004 e në vijim është qiramarrës në objektin godinë 3-katëshe në pronësi të subjektit të rivlerësimit, e analizuar më lart si pasuri.



**68.3** Bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni konstatoi se subjekti ka marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 11.12.2014, në mungesë të një arsyetimi ligjor të qartë, të kuptueshëm, pa një analizë dhe interpretim logjik. Vendimi ka një mangësi të dukshme të analizës së provave dhe fakteve që kanë çuar subjektin në një vendimmarrje të tillë dhe aplikim të dispozitave përkatëse. Ky vendim është marrë edhe në kushtet e konfliktit të interesit. Kontrata e qirasë, e lidhur midis personit të lidhur dhe avokatit të çështjes, është një marrëdhënie që sjell përfitime të ndërsjella për palët. Kjo marrëdhënie me qiramarrësin, në rastin konkret ngre dyshime për cenim të parimit të paanësisë dhe/ose të objektivitetit në vendimmarrje nga subjekti i rivlerësimit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**68.4** Subjekti, në prapësime në lidhje me konstatimin sa më sipër të Komisionit, është shprehur vetëm për konfliktin e interesit, për të cilin thotë se do të shprehet në çështjet në vijim.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**68.5** Trupi gjykues vlerësoi se subjekti ka dhënë vendimin sa më sipër në mungesë të një arsyetimi ligjor të qartë, të kuptueshëm, pa një analizë dhe interpretim logjik, si dhe në kushtet e konfliktit të interesit.

**68.6 Në përfundim**, trupi gjykues çmon se konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

**69. Lidhur me dosjen nr. 4, që i përket çështjes civile me nr. \*\*\* akti, datë 28.2.2014** regjistrimi, me objekt “Detyrimin e të paditurit të më kompensojë burgim të padrejtë të vuajtur për periudhën kohore 19.7.2010 – 30.11.2010, në shumën 289,000 lekë”. Subjekt ka vendosur: “Moskompetencën për shqyrtimin e çështjes civile nr. \*\*\*, datë 28.2.2014”. Ndaj vendimit të mësipërm nuk është ushtruar ankim nga palët dhe çështja është pranuar për gjykim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë.

**69.1** Nga hetimi kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezulton se subjekti i rivlerësimit Hektor Sinanaj ka marrë vendimin sa më sipër në mungesë të një arsyetimi ligjor të qartë, të kuptueshëm, pa një analizë juridike dhe pa një interpretim të dispozitave ligjore të rastit dhe në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**69.2** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me konstatimin sa më sipër të Komisionit. Ai është shprehur se shpjegimet për arsyetimin e këtij vendimi i bazon në të njëjtat argumente të parashtruara edhe në vendimet e mësipërme.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**69.3** Trupi gjykues çmon se subjekti ka dhënë vendimin në mungesë të një arsyetimi ligjor të qartë, të kuptueshëm, pa një analizë juridike dhe pa një interpretim të dispozitave ligjore të rastit dhe në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar.

**69.4 Në përfundim**, trupi gjykues çmon se konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

### **TË DHËNAT NGA BURIMET ARKIVORE TË KLGJ-së**

**70.** Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Hektor Sinanaj janë paraqitur në Inspektoratin e KLD-së 10 ankesa (1 në vitin 2014, 7 në vitin 2015 dhe 2 në vitin 2016). Nga këto, 1 ankesë e vitit 2014 dhe 2 ankesa të vitit 2015 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, pasi pretendimet mund të shqyrtohen vetëm nëpërmjet apelimit gjyqësor; 2 ankesa të vitit 2015 janë arkivuar, pasi kanë rezultuar të përsëritura; 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për shkelje formale të ligjit; 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për zvarritje të gjykimit nga ana e gjyqtarit. Nga hetimi rezultoi se për 1 ankesë të vitit 2015 është vendosur mbajtja në vijim deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Lartë; 1 ankesë e vitit 2016 është arkivuar, pasi rezulton të jetë ankesë e përsëritur; për 1 ankesë të vitit 2016 është sugjeruar verifikim për mosrespektim formal të ligjit.

**71.** Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Hektor Sinanaj përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

**72.** Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2023, ka bashkëlidhur edhe kopje të praktikës për procedimin disiplinor për subjektin e rivlerësimit në vitin 2004, si vijon:

- Vendimi nr. \*\*\*, datë 16.7.2004, i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet të cilit është vendosur të japë masë disiplinore ndër të tjera edhe gjyqtarit Hektor Sinanaj të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, t’i jepet masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”.

- Vendimi nr. \*\*\*, datë 16.7.2004, i Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” ndaj gjyqtarit Hektor Sinani”. Masa disiplinore sa më sipër i është dhënë pas verifikimit të 9 vendimeve penale të gjykuara nga trup gjykues në përbërje të të cilit ka qenë edhe subjekti Hektor Sinanaj. Si përfundim, KLD-ja ka konkluduar se gjykata, trupi gjykues në përbërje të të cilit ka qenë edhe gjyqtari Hektor Sinani, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat materiale dhe pikërisht nenin 59 të Kodit Penal. Në rastin konkret, gjykata ka pranuar ekzistencën e një vepre penale me rrezikshmëri shoqërore të theksuar, çka përbën një nga kriteret për të vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore të autorit. Gjithashtu, ajo është në kundërshtim me nenet 382 dhe 383 të Kodit të Procedurës Penale, ka mungesë arsytimi në drejtim të rrethanave të kryerjes së veprës penale, në kuptim të nenit 59 të Kodit Penal, duke mos arsyetuar për ekzistencën e ndonjë rrethane të veçantë të kryerjes së saj. Gjithashtu, ka vepruar dukshëm në kundërshtim me nenin 47 të Kodit Penal për caktimin e dënimit.

**73.** Referuar informacionit të përcjellë në Komision nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë<sup>68</sup>, ndaj subjektit të rivlerësimit për periudhën 2018 – 2021 janë përcjellë gjithsej 32 ankesa.

**74.** Gjithashtu, për subjektin Hektor Sinanaj rezulton se është marrë vendimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2021, “Për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Hektor Sinanaj me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”. Në këtë vendim është vendosur:

- *Përfundimi i hetimit disiplinor ndaj magjistratit Hektor Sinanaj, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për shkelje disiplinore, parashikuar nga neni 102, pika*

<sup>68</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2023 (administruar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2023).

2, shkronja "a" e ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.

- Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstratit Hektor Sinanaj, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për shkelje disiplinore, parashikuar nga neni 102, pika 2, shkronja "a" e ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.
- Propozimin e masës disiplinore "Ulje e përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë jo më gjatë se një vit", parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja "c", ndarja "i" dhe neni 108 i ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.
- Dërgimin e raportit të hetimit disiplinor së bashku me dosjen hetimore pranë institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në marrjen e vendimit sa më sipër, është iniciuar nga ankesat e dy shoqërive "\*\*\*\*" sh.a.<sup>69</sup> dhe \*\*\* ndaj disa vendimeve të dhëna nga subjekti Hektor Sinanaj.

**75.** Në ankesën e saj shoqëria "\*\*\*\*" sh.a., drejtuar Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, ankohet mbi praktikën që ndjek gjyqtari Hektor Sinanaj në lëshimin e urdhrave të ekzekutimit për këtë shoqëri në shkelje flagrante të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj shoqërie, ky gjyqtar në kundërshtim me parashikimin ligjor të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, në mënyrë të përsëritur ka rrëzuar kërkesat e saj me arsyetimin se akti kredidhënës (kontrata e huas) duhet të ketë formë noteriale. Disa nga vendimet janë ankimuar dhe Gjykata e Apelit Vlorë ka prishur vendimet e gjyqtarit Hektor Sinanaj duke vendosur lëshimin e urdhrit ekzekutiv, mirëpo pavarësisht kësaj ky gjyqtar ende ka vijuar të zbatojë pa të drejtë praktikën e tij. Në ankesën e saj, shoqëria "\*\*\*\*" sh.a. ka renditur disa vendime, për të cilat pretendon se subjekti Hektor Sinanaj nuk ka dhënë vendim të drejtë e të bazuar në ligj.

**76.** Në ankesën drejtuar Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, BKT-ja<sup>70</sup> ankohet mbi pengesat dhe zvarritjet e proceseve gjyqësore, si dhe mbi vendimet e paligjshme në lidhje me shqyrtimet gjyqësore, gjykuar nga gjyqtari Hektor Sinanaj. Ankohet se ky gjyqtar është shprehur jashtë objektit të padisë në një rast pezullimi të veprimeve përmbartimore, duke vendosur sigurimin e padisë në kundërshtim me parashikimet ligjore. Në një rast tjetër, sipas bankës, gjyqtari Hektor Sinanaj ka dhënë një vendim, i cili është prishur nga Gjykata e Lartë, edhe pse Gjykata e Apelit kishte vendosur të lihet në fuqi.

**77.** Bazuar në raportin e hetimit disiplinor nr. \*\*\* prot., datë 26.3.2021, në cilësinë e provës gjatë hetimit, në ILD janë administruar një numër i madh vendimesh gjyqësore, me palë ndërgjyqëse shoqëria "\*\*\*\*" sh.a. dhe vendime me palë ndërgjyqëse \*\*\*, lista seancash dhe CD. Gjithashtu, gjatë hetimit janë marrë shpjegime nga subjekti Hektor Sinanaj dhe është proceduar duke mbajtur procesverbalet përkatëse. Në raport shpjegohen të detajuara të gjitha shkeljet e subjektit gjatë marrjes së vendimeve për këto dy subjekte ankuese.

**77.1** Në përfundim të hetimit disiplinor, ILD-ja veprimet e kryera nga ana e subjektit i ka konsideruar shkelje shumë të rënda që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 9877/2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në

<sup>69</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2017 (te përgjigjja e ILD-së nr. \*\*\*, datë 9.3.2021, e KLGJ-së).

<sup>70</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.8.2017 (te përgjigjja e ILD-së nr. \*\*\*, datë 9.3.2021, e KLGJ-së).

Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 115, pika 1 parashikohen në mënyrë joshteruese si kritere për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore, si lloji dhe rrethanat e shkeljes, shkalla e fajësisë dhe motivi, pasojat e shkeljes, të dhënat profesionale të çështjeve disiplinore etj.

**77.2** Në rastin konkret, sipas raportit të hetimit disiplinor të ILD-së, rezulton se shkeljet procedurale të kryera nga magjistrati provohet të jenë me dashje direkte. Në analizë të kriterit “Pasojë e shkeljes” rezulton se si pasojë e veprimeve të kryera ka sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë bazuar në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Duke qenë se shkelja ka qenë vazhduese referuar nenit 115 pika 4 shkronja “b” e ligjit 96/2016 për Statusin, i ndryshuar kjo rrethanë vlerësohet rënduese.

**77.3** Mbi bazën e këtij raporti, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mori vendimin sa më sipër nr. \*\*\* prot., 28.7.2021, “Për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Hektor Sinanaj, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”, duke i propozuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë marrjen e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë jo më gjatë se një vit”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “c”, ndarja “i” dhe neni 108 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**78.** Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas shqyrtimit të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, zhvilloi seancë dëgjimore për rastin. Në përfundim, me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.10.2021, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarit Hektor Sinanaj”, KLGJ-ja ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Vendosjen e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistratit Hektor Sinanaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë”. KLGJ-ja në vendimin e saj, ndër të tjera, arsyeton se në rastin konkret shkeljet disiplinore të kryera nga magjistrati, të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja “a” e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është arritur në përfundimin se përbëjnë *shkelje të lehtë disiplinore*. Në mbështetje të neneve 106 dhe 107 të ligjit, për shkelje të lehta disiplinore mund të jepet masa disiplinore “Vërejtje konfidenciale” ose “Vërejtje publike”. Të dyja këto masa mund të jepen për shkelje të lehta, por në rastin konkret, Këshilli vlerësoi se ndaj magjistratit, referuar të gjitha fakteve të konstatuara dhe analizës ligjore të tyre, kritereve të cilave përcaktojnë rëndësinë e shkeljes të analizuara në këtë vendim, si dhe rrethanave lehtësuese, arrihet në përfundimin se ndaj magjistratit Hektor Sinanaj duhet të vendoset masa disiplinore “Vërejtje publike”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “b” dhe neni 107 i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**79.** Sa më sipër, rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit janë marrë disa masa disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit.

**80.** Referuar përgjigjeve të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme, konfirmohet se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për subjektin e rivlerësimit Hektor Sinanaj janë regjistruar 7 referime penale, për të cilat organi i Prokurorisë ka vendosur për procedimin penal nr.\*\*\*, datë 25.2.2015, pushuar në datën 25.5.2015; kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 8.6.2015, mosfillim datë 6.7.2015; kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 18.1.2016, mosfillim datë 7.3.2016; kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 8.1.2018, mosfillim datë 22.1.2018; kallëzimin penal

nr. \*\*\*, datë 28.5.2019, mosfillim datë 31.5.2019; kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 6.10.2020, mosfillim datë 20.10.2020; si dhe për kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 9.12.2021, ka vendosur mosfillim datë 9.12.2021.

## DENONCIME

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Hektor Sinanaj janë administruar 31 denoncime nga publiku. Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kërkoi shpjegime për 12 denoncime, si vijon:

**81. Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2017<sup>71</sup>**, të shtetasit N.LL, i cili denoncon gjyqtarin Hektor Sinanaj se gjatë procesit të gjyqimit ai i ka diktuar një emër të caktuar ekspertit me të cilin dyshon se kanë lidhje (njohje) me njëri-tjetrin. Ai pretendon se inxhinieri (eksperti i thirrur në gjykimin e çështjes gjyqësore) i paguan qiranë e zyrës këtij gjyqtari. Gjithashtu pretendon se inxhinieri e ka pyetur nëse do t'i jepte para gjyqtarit, por ai nuk ka pranuar. Më tej, në denoncim, ky shtetas shprehet se pasi gjyqtari Sinanaj ka rrëzuar padinë, inxhinieri (eksperti) i ka thënë se gjyqtari kërkoi 1 milion lekë (të vjetra).

**81.1** Nga hetimi rezultoi se subjekti ka dhënë vendimin nr. \*\*\*, datë 21.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Vlorë, që i përket palës denoncuese, ku është vendosur: “Rrëzimi i kërkesëpadisë”. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.11.2021, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; Pranimin e kërkesëpadisë. Vërtetimin e faktit juridik”. Në këtë vendim, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë *është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit procedural civil, si dhe e vlerësimit jo të drejtë të provave të marra në shqyrtim gjatë gjyqimit në shkallë të parë*. Vendimin sa më sipër kjo gjykatë e ka bazuar mbi të njëjtat prova dhe mbi të njëjtin akt ekspertimi të bërë nga eksperti F.H gjatë gjyqimit në shkallë të parë nga gjyqtari Sinanaj. Vendimi i Apelit është i formës së prerë, pasi nuk rezulton të jetë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

**81.2** Nga aktet e depozituara nga subjekti për deklarimin *Vetting* rezulton se eksperti F.H është qiramarrës në objektin në pronësi të subjektit Hektor Sinanaj, për periudhën 2017 – 2021. Denoncimi i shtetasit N.LL është i datës 12.12.2017, në kohën kur eksperti F.H kishte marrë ambient me qira në godinën në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

**81.3** Subjekti Hektor Sinanaj, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, është pyetur dhe ka dhënë shpjegime në lidhje me qiramarrësin, ekspertin F.H dhe, në përgjigje të pyetësorit shprehet se: *“Vendimi është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë... Nga ana ime si gjyqtar, ky vendim iu bë me dije ekspertit topograf qiramarrës në kontratën e përpiluar nga bashkëshortja ime për sa më sipër dhe nuk ka pranuar të ketë marrë shumën prej 100,000 lekësh, por ka marrë vetëm shpërblimin e tij si ekspert. Nga ana ime si gjyqtar iu kërkua të bëjë denoncim për shpifje. Nuk di më pas nëse ka bërë denoncim... ”*.

**81.4** ILD-ja konfirmon se shtetasi N.LL i është drejtuar edhe ILD-së me ankesë ndaj gjyqtarit Hektor Sinanaj për të njëjtat shkaqe që ka paraqitur edhe denoncimin sa më sipër, adresuar në Komision. Në vendimin datë 31.1.2022, ILD-ja ka vendosur arkivimin e ankesës, duke

---

<sup>71</sup> Bashkëlidhur denoncimit, kopje e aktit të ekspertimit nga F.H. Shkresa e Arkivit Qendror Shtetëror nr. \*\*\* prot., datë 13.9.2016.

arsyetuar se pretendimet e ankuesit në thelb janë pretendime që lidhen me natyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore dhe vlerësimin e provave nga gjykata respektive.

**81.5** Komisioni çmoi nga hetimi se vendimi i gjykatës së shkallës së parë, ndryshe nga sa shprehet subjekti në shpjegimet e pyetësorit nr. 3, është ndryshuar nga Gjykata e Apelit dhe është gjykuar në themel, duke u vendosur pranimi i padisë së palës kërkuese dhe denoncuese në Komision mbi të njëjtat prova të administruara gjatë gjykimit në shkallë të parë, duke arsyetuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit procedural civil, si dhe e vlerësimit jo të drejtë të provave të marra në shqyrtim gjatë gjykimit në shkallë të parë nga subjekti Hektor Sinanaj. Vendimi i Apelit është i formës së prerë, pasi nuk rezulton të jetë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

**81.6** Gjithashtu, gjatë hetimit u konstatua se për shkak të marrëdhënies juridike me qiramarrësin (ekspertin) F.H, gjyqtari ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit gjatë gjykimit të çështjes sa sipër, me kërkues N.LL.

**81.7** Pengesat ligjore të vendosura nga ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, ligji nr. 96/2016, neni 72 i Kodit të Procedurës Civile, synojnë të rregullojnë marrëdhënie të caktuara mes palëve në procese gjyqësore, marrëdhëniet midis të cilave mund të ngrenë dyshime për njëanshmëri në zgjidhjen juridike të procesit gjyqësor, duke humbur kështu besimin e publikut për drejtësinë në gjykata. Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**81.8** Subjekti i rivlerësimit gjatë prapësimeve nuk është shprehur në lidhje me barrën e provës.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**81.9** Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka cenuar të drejtat e palëve në proces, duke dhënë një vendim në interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit procedural civil, si dhe të vlerësimit jo të drejtë të provave të marra në shqyrtim gjatë gjykimit në shkallë të parë. Gjithashtu, gjatë hetimit u konstatua se për shkak të marrëdhënies juridike me qiramarrësin (ekspertin) F.H, gjyqtari ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit gjatë gjykimit të çështjes sa më sipër, me kërkues N.LL.

**81.10 Në përfundim**, trupi gjykues çmon se konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

**82. Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2018**, shtetasi G.M ankohet për vendimin e marrë ndaj tij nga ky subjekt me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**82.1** Gjatë hetimit rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.10.2014, ka vendosur: “Pushimin e gjykimit për shkak të heqjes dorë dhe largimit nga seanca të palës paditëse k/paditur. Vazhdimin e gjykimit për kërkimet e kundërpadisë”.

**82.2** Kundër vendimit të mësipërm është ushtruar ankim nga pala paditëse e kundërpaditur në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.12.2016, ka vendosur: “Prishjen e vendimit datë 8.10.2014 dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit të kërkesë padisë pranë të njëjtës gjykatë me të njëjtin trup gjykues”. Në përfundim, Gjykata e Apelit ka arritur në konkluzionin se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. \*\*\*, datë 8.10.2014, është

*rrjedhojë e zbatimit dhe interpretimit të gabuar të ligjit procedural dhe, si i tillë, duhet të priset dhe çështja të kthehet për vazhdimin e gjykimit pranë të njëjtës gjykatë dhe me të njëjtin trup gjykues... për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin procedural që ka të bëjë me përcaktimet e neneve 179<sup>72</sup> dhe 299<sup>73</sup> të Kodit të Procedurës Civile për të dhënë një vendim të bazuar në ligj. Ky proces është zhvilluar mbi dy vjet gjykim në shkallë të parë dhe në datën 8.10.2014, kur zhvillohet seanca për njohjen dhe diskutimin me aktin e ekspertimit, gjykata, për shkak se u largua përfaqësuesi i paditësit, avokati i zgjedhur prej tij për mosmarrëveshjet që kishin për ekspertin, ka vendosur pushimin e gjykimit të padisë. Në arsyetim, Gjykata e Apelit shprehet se që të jemi para nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile duhet që pala të mos jetë paraqitur në seancë gjyqësore dhe që të jemi para nenit 299 të këtij Kodi duhet që kërkesa për heqje dorë të jetë me shkrim ose e deklaruar në seancë gjyqësore. Asnjë nga këto shkaqe nuk ekziston në kërkesën objekt gjykimi. Gjithashtu, kjo gjykatë arsyeton se as largimi në zbatim të nenit 178 të Kodit të Procedurës Civile prej gjykatës i paditësit, as lënia e sallës së gjyqit qoftë edhe pa sqarime të rastit nga përfaqësuesi i paditësit, nuk mund të konsiderohen heqje dorë nga gjykimi i padisë (neni 299 i Kodit të Procedurës Civile) apo mosparaqitja e palëve sipas nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile, siç pa të drejtë dhe në mënyrë të gabuar janë interpretuar nga gjykata e shkallës së parë.*

**82.3** Kjo çështje është ankimuar me rekurs në Gjykatën e Lartë, regjistruar me nr. \*\*\*, datë 4.1.2017, aktualisht nuk ka ndonjë vendimmarrje në lidhje me të. Çështja ndodhet ende në Dhomë Këshillimi.

**82.4** Nga sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor objekt denoncimi nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin procedural që ka të bëjë me përcaktimet e neneve 179<sup>74</sup> dhe 299<sup>75</sup> të Kodit të Procedurës Civile për të dhënë një vendim të drejtë e të bazuar në ligj. Në këto kushte, Komisioni, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës subjektivit për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

### **Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit**

**82.5** Subjekti i rivlerësimit gjatë prapësimeve nuk ka dhënë asnjë shpjegim për rastin sa më sipër.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**82.6** Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin procedural që ka të bëjë me përcaktimet e neneve 179 dhe 299 të Kodit të Procedurës Civile.

**82.7 Në përfundim,** trupi gjykues çmon se konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

---

<sup>72</sup> Neni 179 “Pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve” parashikon: “Nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten, si në veprimet përgatitore ashtu edhe në seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit”.

<sup>73</sup> Neni 299 parashikon: “Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: a) .....; b) paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë; c) pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj”.

<sup>74</sup> Neni 179 “Pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve” parashikon: “Nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten, si në veprimet përgatitore ashtu edhe në seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit”.

<sup>75</sup> Neni 299 parashikon: “Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: a) .....; b) paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë; c) pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj”.

**83. Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2023<sup>76</sup>**, të shtetasit M.I, i cili ankohet se ka dhënë një vendim të pambështetur në prova, ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor, pasi nuk është thirrur pala që cenohet, pronarët e truallit, të cilët disponojnë dokumentacion të rregullt pronësie (certifikatë pronësie). Ai denoncon se gjyqtari ka shfaqur njëanshmëri gjatë procesit, e ka dhënë këtë vendim për arsye korruptive, si dhe ka trajtuar gabim objektin e gjykimit.

**83.1** Nga hetimi rezulton se me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 12.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur pranimi i padisë. Ky vendim është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.1.2019, ka vendosur prishjen e vendimit të sa më sipër të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues, ndër të tjera, me arsyetimin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në shkelje të normave procedurale. Në nenin 193 të Kodit të Procedurës Civile është parashikuar mundësia e thirrjes së personit të tretë nga gjykata kur kjo e çmon se gjykimi duhet të zhvillohet në prani të tij, pasi nga të dhënat rezulton se ai ka interes në zgjidhjen e çështjes, prandaj në rigjykim duhet të thirren, në cilësinë e personit të tretë, bashkëpronarët e truallit, midis të cilëve edhe shtetasi M.I, për sa kohë ai së bashku me paditësin J.D në deklaratën noteriale (objekt gjykimi) rezultojnë me statusin e pronarit të truallit. Thirrja e personit të tretë do të japë shpjegime lidhur me pozitën e paditësit në këtë çështje, për të sqaruar faktin nëse paditësi përfshihet ose jo në pronarët e truallit.

**83.2** Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë (regjistruar nr. \*\*\*, datë 29.6.2020).

**83.3** Në analizë të provave, fakteve dhe kuadrit ligjor rezulton e provuar se vendimi nr. \*\*\*, datë 12.10.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është marrë në shkelje të normave procedurale, përkatësisht thirrjes dhe pjesëmarrjes në gjykim të personave të tretë, në kundërshtim me nenin 193 të Kodit të Procedurës Civile, duke cenuar elementët e procesit të rregullt ligjor.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**83.4** Subjekti i rivlerësimit gjatë prapësimeve dhe në seancë nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me konstatimet e Komisionit.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**83.5** Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin procedural që ka të bëjë me përcaktimet e nenit 193 të Kodit të Procedurës Civile, duke cenuar elementet e procesit të rregullt ligjor.

**83.6 Në përfundim**, trupi gjykues çmon se konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

**84. Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2018<sup>77</sup>**, të shtetasës A.L, e cila ankohet se subjekti ka dhënë një vendim të paragjykuar, në kundërshtim me kontratën bazë që ishte objekt i padisë dhe ka marrë parasysh një aneks kontratë që ka qenë paraprake dhe që nuk është

<sup>76</sup> Kopje vendimi nr. \*\*\*, datë 12.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; kopje të deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. 2912 kol., datë 9.10.2012.

<sup>77</sup> Kopje të procesverbaleve të seancave gjyqësore: kopje e vendimit nr. \*\*\*, datë 3.4.2018; kopje e kontratës datë 18.8.2009; kopje e aktit të ekspertimit përfundimtar datë 25.1.2018.



realizuar 100%. Ajo pretendon se ky gjyqtar ka keqinterpretuar provat, nuk është shprehur dhe nuk ka arsyetuar sipas objektit të padisë, si dhe ka zgjatur procesin gjyqësor për 3 vjet, pa shkaqe të paarsyeshme.

**84.1** Nga hetimi rezultoi e provuar se kemi tejkalim të afatit të arsyeshëm të gjyqimit, i cili në disa raste rezulton se ka ardhur për shkaqe të kërkesave të palëve për shtyrje të seancave, mosparaqitje të ekspertëve apo nga kërkesat e tyre për shtyrje, si dhe nga gjendja shëndetësore e gjyqtarit, i cili ka qenë me raport mjekësor. Nga leximi i kopjeve të procesverbaleve vërehet se seancat janë të shkurtra dhe joproductive. Sipas procesverbalit të seancës së datës 13.3.2018, në këtë datë është vendosur shtyrja e seancës, me qëllim shpalljen e arsyetuar të vendimit, shtetasja A.L ka shënuar me dorë se: *“Morën dijeni për seancën 28.3.2018 për vendimin e arsyetuar. U paraqitëm, por doli sekretarja dhe na lajmëroi se mungon gjyqtari dhe do t’ju njoftojmë. Për datën 3.4.2018 nuk jemi njoftuar. Kështu vendimi u dha në mungesë”*. Nga leximi i procesverbalit të seancës datë 3.4.2015 rezulton se gjyqtari ka çelur seancën dhe ka konstatuar: *“Nuk u paraqit paditësja A.L. Nuk u paraqit përfaqësuesi i paditësit E. V. Nuk u paraqitën përfaqësuesit e të paditurve, S.F dhe L.Z, av. I.D dhe ka shpallur vendimin sipas dispozitivit, pa u shprehur mbi shkakun e mosparaqitjes së palëve apo mbi marrjen apo jo dijeni të kësaj seance, duke qenë se seanca e kaluar nuk ishte zhvilluar për shkak të mungesës së tij për arsye shëndetësore”*.

**84.2** Nga shkresa kthim përgjigjeje e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë rezulton se ndaj vendimit të mësipërm është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit në datën 2.7.2018. Nga konsultimi me faqen gjykatat.gov.al nuk rezulton që deri tani të jetë zhvilluar procesi gjyqësor në Gjykatën e Apelit.

**84.3** Sa më sipër, rezultoi e provuar se subjekti ka zgjatur gjykimin e këtij procesi për 3 vjet, duke cenuar të drejtat e palëve në proces dhe, për pasojë, cenimin e procesit të rregullt gjyqësor.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**84.4** Subjekti i rivlerësimit gjatë prapësimeve nuk është shprehur në lidhje me konstatimin sa më sipër të Komisionit.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**84.5** Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin procedural, duke cenuar elementet e procesit të rregullt ligjor.

**84.6 Në përfundim**, trupi gjykues çmon se konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

**85. Lidhur me denoncimin nr. \*\*\*, datë 26.4.2019, nga Banka \*\*\*, e cila ka ngritur pretendime për disa vendimmarrje nga të cilat, për tre prej tyre, Komisioni, në përfundim të hetimit, ka konstatuar problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit, si më poshtë:**

- Lidhur me kërkesën e Bankës \*\*\* “Për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për kontratën e kredisë bankare të datës 24.9.2014 lidhur me debitorin “S.H”, gjykata ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se kontrata e kredisë nuk është akt material, pasi nuk është nënshkruar para noterit publik dhe, si e tillë, nuk është titull ekzekutiv”, banka

pretendon se është marrë një vendim në kundërshtim me nenin 510, shkronja “d” e Kodit të Procedurës Civile mbi titujt ekzekutivë.

- Lidhur me kërkesën e datës 16.5.2016 “Për lëshim e urdhrin të ekzekutimit për kontratën e shërbimeve bankare individuale, overdraft të datës 5.6.2014 me debitorin S.H, në këtë proces”, gjykata me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 16.5.2016, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se kontrata e overdraftit nuk përbën kontratë bankare pasi nuk është akt noterial dhe, si i tillë, nuk është titull ekzekutiv”.
- Lidhur me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 3.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për kërkesën e Bankës \*\*\* “Për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për kontratën e shërbimeve në bankën individuale – overdraft të datës 9.1.2015”, me debitoren V.GJ.
- Lidhur me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.1.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurit F.M t’i paguajë paditëses E.K shumën e marrë hua prej 6,500,000 lekësh. Vendosijen e sekuestros mbi pasuritë e të paditurit F.M, me nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, respektivisht mbi një shtëpi banimi dhe një sipërfaqe trualli prej 570 m<sup>2</sup>, regjistruar në ZVRPP Vlorë”.
- Lidhur me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, palë paditëse SH.I dhe palë e paditur Banka \*\*\*, me objekt “Detyrimin e të paditurit \*\*\*, dega Vlorë, t’i rimbursojë paditëses shumën 1,078,900 lekë në llogarinë bankare nr. \*\*\*\*”, ku është vendosur: “Pranimi i kërkesëpadisë së paditëses SH.I. Detyrimin e palëve të paditurit \*\*\* Vlorë dhe personit të tretë shoqëria përmbarimore private “\*\*\*\*” sh.p.k. t’i kthejë paditëses shumën 1,078,900 lekë në llogarinë bankare nr. \*\*\*\*”, pretendohet se nga ana e gjyqtarit Hektor Sinanaj janë bërë shkelje procedurale, që kanë ndikuar në dhënien e vendimit përfundimtar.

## **Vlerësimi i Komisionit**

**85.1** Nga hetimi rezultoi se për këto raste dhe për të tjera të së njëjtës natyrë, Banka Kombëtare Tregtare i është drejtuar me ankesë edhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Trajtimi i kësaj problematike nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë është trajtuar në pikat 74 - 76 - 77 të vendimit. Duke qenë se për këto çështje ka një masë disiplinore për subjektin e rivlerësimit, qëndrimi i Komisionit përputhet me vlerësimin e bërë nga organet kompetente.

**86. Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2019**, shtetasi A.GJ ankohet për vendimmarrje të padrejtë në vendimin penal nr. \*\*\*, datë 9.7.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë të përbërë nga gjyqtarët Hektor Sinanaj, TH.N dhe L.M me palë: i pandehur A.GJ, akuzuar për veprën penale të marrjes së mitës 2 herë, parashikuar në Kodin Penal. Pala akuzuese: Prokuroria e Rrethit Vlorë, është vendosur: “Të deklarojë fajtor të pandehurin A.GJ për kryerjen e veprës penale të mitmarrjes nga ana e shtetasve S.SH dhe M.K dhe në bazë të neneve 160 e 49 të Kodit Penal dënohet me 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim”.

**86.1** Nga hetimi rezultoi se i pandehuri (denoncuesi) A.GJ në shkallë të parë është mbrojtur nga av. L.XH. Në pyetësorin nr. 3, subjekti ka deklaruar ndër të tjera se shtetasi L.XH, me profesion avokat, ka qenë me qira në pasurinë e tij që më përpara vitit 2000 deri në vitin 2004. Edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë konfirmohet se av. L.XH ka qenë përfaqësues në shumë raste

i palëve në procese gjyqësore të gjykuara nga subjekti Hektor Sinanaj (rreth 37 çështje të verifikuara deri tani që nga viti 2000 e në vijim).

**86.2** Sa më sipër, duke qenë se nga hetimi rezultoi se av. L.XH ka lidhur kontratë qiraje me subjektin për një zyrë në godinën 3-katëshe, në pronësi të subjektit Hektor Sinanaj, trupi gjykues çmoi se subjekti ka vepruar në këtë rast gjykimi në kushtet e konfliktit të interesit.

**86.3** Qëndrimi i subjektit dhe vlerësimi i kësaj problematike të konstatuar do të trajtohen gjerësisht në pikën 93 të këtij vendimi “Gjetje të tjera”.

**87. Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2019,** të shtetasit S.L.Z, i cili denoncon subjektin Hektor Sinanaj për mungesë etike, si dhe ka zhvilluar një hetim gjyqësor në kundërshtim me ligjin procedural dhe material. Për të gjitha sa ka parashtruar në ankesë.

**87.1** Nga hetimi ka rezultuar se me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.1.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që i përket paditësit S.Z, me objekt padie “Vërtetim fakti juridik të pronës tokë kullotë të trashëguar nga gjyshi S.Z që nga periudha osmane deri sot, që familja i disponon në fshatin D”, është vendosur rrëzimi i kërkesës si e pabazuar në ligj dhe në prova. Në vendim arsyetohet ndër të tjera se: *“Kërkesa nuk bazohet në dokumente arkivore pronësie të mirëfillta, si indicie që legjitimojnë kërkuesit për vërtetimin gjyqësor të faktit juridik të pronësisë, duke mos pasur të dhëna e përputhje me pretendimin për një sipërfaqe toke kullotë prej 148 hektarësh në fshatin D, në emër të L.Z (S)...”*.

**87.2** Ky vendim është ankimuar në Apel nga shtetasi S.Z në datën 14.1.2019, por ende nuk ka një vendim përfundimtar.

**87.3** Duke qenë se kjo çështje është ende në gjykim, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, trupi gjykues çmon se kjo çështje nuk mund të jetë objekt i procesit të rivlerësimit.

**88. Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2021, të shtetasit E.I.V** (Dhoma e Avokatëve Vlorë), i cili ankohet për mungesë etike, mosnjohje të procedurës civile dhe mosrespektim të asnjë norme, për paaftësi të dukshme në arsyetimin e vendimeve të gjyqtarit Hektor Sinanaj. Ky shtetas pretendon se në procesin civil me palë E.V kundër E.T, ky subjekt nuk ka respektuar asnjë dispozitë për marrjen e provave dhe ka një mangësi të theksuar etike. Po kështu, edhe në procesin e shtetasit B.H kundër ATP-së ka demonstruar mungesë etike dhe fyerje. Për të qenë më konciz, në asnjë proces civil nuk respekton procedurën, etikën dhe është tërësisht i paaftë në kufijtë e të pabesueshmes, mjaft të shikohet një proces çfarëdo civil.

**88.1** Nga hetimi Komisioni konstatoi se si vendimi nr. \*\*\*, datë 13.7.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ashtu edhe vendimi nr. \*\*\*, datë 12.4.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, konsiderohen ende si çështje në procese gjyqësore.

**88.2** Por nga analiza e vendimit të dytë konfirmohet se subjekti në këtë proces gjyqësor ka thërritur ekspert topografin F.H, i cili rezulton të jetë një nga qiramarrësit në godinën në pronësi të tij.

**88.3** Sa më sipër, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit Hektor Sinanaj ka ushtruar funksionin publik në kushtet e konfliktit të interesit.

**88.4** Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

**88.5** Qëndrimi i subjektit dhe vlerësimi i kësaj problematike të konstatuar do të trajtohen gjerësisht në pikën 93 të këtij vendimi “Gjetje të tjera”.

**89. Lidhur me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 4.6.2021, të shtetasit M.XH,** i cili ankohet se subjekti nuk ka zbardhur vendimin edhe pse gjyqi u zhvillua në datën 11.5.2021, në orën 14:45 dhe deri në datën 4.6.2021 nuk është zbardhur. Ky shtetas kërkon nga Komisioni që vendimi të zbardhet sa më shpejt sepse do ta apelojë atë në Gjykatën e Apelit.

**89.1** Nga hetimi rezultoi se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 11.5.2021, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës; Miratimin e pushimit të procedimit penal të regjistruar për shpërdorim detyre (neni 248 i Kodit Penal)”.

**89.2** Nga hetimi konfirmohet se nga fleta e regjistrit të çështjeve në gjykatë rezulton se çështja penale në fjalë është regjistruar në gjykatë datë 29.12.2020, seanca e parë është zhvilluar në datën 13.2.2021 dhe vendimi është dhënë në datën 11.5.2021. Rezulton se vendimi objekt denoncimi sa më sipër i është dërguar Gjykatës së Apelit në datën 17.9.2021, ndërkohë që gjykimi i çështjes është zhvilluar në datën 11.5.2021. Sa më sipër, subjektit i kaloi barra e provës.

**89.3** Subjekti i rivlerësimit gjatë seancës dhe në prapësime nuk dha shpjegime në lidhje me barrën e provës.

**89.4 Në përfundim,** trupi gjykues çmon se konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

**90. Lidhur me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2023, të shtetasit K.G,** i cili denoncon për shkelje të rëndë ligjore në gjykimin e çështjes civile me palë L.Ç dhe K.G, ku gjyqtari Hektor Sinanaj, me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.4.2017, ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë. Deklarimin absolutisht të pavlefshëm të veprimit juridik kontratë noteriale të shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.3.2004, apartament banimi në lagjen “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, kati i katërt... si kontratë fiktive e stimuluar. Urdhërohet ZVRPP Vlorë të çregjistrojë pronën e mësipërme të të paditurit K.G, regjistruar me kontratën e mësipërme”.

**90.1** Denoncuesi pretendon për zvarritje të procesit në bashkëpunim me ish-pronarin e shtëpisë në fjalë (shtetasin L.Ç), i cili ka qenë kolegu i tij në Sektorin e Përmbarrimit Vlorë dhe sipas këtij fakti, ai nuk duhej të kishte gjykuar procesin dhe në njohjen e tij ligjore edhe këtu ai ka kryer shkelje, kundërvajtje. Denoncuesi dyshon për afëra korruptive midis gjyqtarit Hektor Sinanaj dhe familjes Ç, të cilët janë pronarë të studios ligjore “Ç” dhe opinionin publik shqiptar u bë me njohje nëpërmjet emisionit televiziv “S” për mashtrime në shuma të mëdha.

**90.2** Nga hetimi rezultoi se me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.4.2017, është vendosur: “Pranimi i kërkesëpadisë. Deklarimin absolutisht të pavlefshëm të veprimit juridik, kontratës noteriale të shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.3.2004, apartament banimi në lagjen “\*\*\*\*”... si kontratë fiktive e simuluar. Urdhërohet ZVRPP Vlorë të çregjistrojë pronën e mësipërme të të paditurit K.G, regjistruar me kontratën e mësipërme”. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, por deri në datën 6.11.2023 nuk ka informacion për shqyrtimin e tij.

**90.3** Duke qenë se kjo çështje konsiderohej si një çështje në gjykim, Komisioni hetoi lidhur me faktin e pretenduar të konfliktit të interesit të subjektit me avokatin e çështjes, z. L.Ç. Gjatë procesit subjekti ka deklaruar se në periudhën 5.4.2006 – 5.4.2007, ky avokat ka pasur një zyrë me qira në katin e dytë të godinës, ku qiradhënës ka qenë subjekti Hektor Sinanaj. Po ashtu, ka

deklaruar se vajzat e tij janë avokate, L.Ç dhe A.Ç, të cilat kanë qenë me kontrata qiraje për periudhën 5.4.2006 – 5.4.2009 (kontratat lidhur çdo vit).

**90.4** Sa më sipër, rezulton e provuar se subjekti ka ushtruar funksionin e tij në kushtet e konfliktit të interesit, për faktin se ka gjykuar rastin ku palë ndërgjyqëse ka qenë shtetasi L.Ç, qiramarrës në objektin në pronësi të tij. Për sa më sipër, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

**90.5** Qëndrimi i subjektit dhe vlerësimi i kësaj problematike të konstatuar do të trajtohen gjerësisht në pikën 93 të këtij vendimi “Gjetje të tjera”.

**91. Lidhur me kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2023**, dërguar nga përfaqësues të studios ligjore “J”, përfaqësuar nga av. A.LL dhe O.S, ku objekt i saj është fillimi i procedimit administrativ dhe ndjekja penale e subjektit Hektor Sinanaj, akuzuar për veprat penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja dhe deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257, paragrafi 2 i Kodit Penal, “Pastrim i produktit të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal dhe “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180/3 i Kodit Penal.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**91.1** Problematikat e trajtuara në këtë denoncim Komisioni i ka trajtuar në komponentin e vlerësimit të pasurisë dhe në atë të vlerësimit profesional.

### **92. Lidhur me denoncimet e bëra në burime të hapura**

**92.1** Nisur nga transmetimi në emisionin “S” në TV \*\*\* të denoncimeve ndaj subjektit Hektor Sinanaj, Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2023, iu drejtua këtij televizioni për të marrë materialet që kanë të bëjnë me denoncimet rreth këtij subjekti. Në përgjigje të shkresës së Komisionit, TV \*\*\*, bashkëlidhur me shkresën e tyre nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2023, ka dërguar kopje të CD-së për pamjet e transmetuara e të bëra publike.

**92.2** Nga analiza e emisioneve përkatëse rezultuan tri problematika të ngritura lidhur me subjektin e rivlerësimit, konkretisht:

- Zhvillimi i procesit gjyqësor që i përket të pandehurit H.GJ, proces i cili ka qenë ende duke u zhvilluar në kohën e zhvillimit të procesit të rivlerësimit.
- Problematika që lidhen me fshehje, deklarim të rremë të pasurive dhe interesave privatë të personave të lidhur (për aktivitetin privat, kopshti “P”, në emër të bashkëshortes së subjektit), si dhe për konflikt interesi sepse në godinën e tij 3-katëshe, ky subjekt, zyrtar në pronësi të tij, ua ka dhënë avokatëve dhe ekspertëve, të cilët janë pjesë të proceseve gjyqësore të gjykuara prej tij nga viti 2000 e në vazhdim.
- Akuza që subjekti ka kryer për veprën penale, refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja dhe deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë, fshehja e të ardhurave të tij dhe të personave të lidhur me të.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**92.3** Problematikat e trajtuara në këtë denoncim, të cilat janë në kuadër të procesit të rivlerësimit, janë trajtuar në këtë vendim si në analizën e kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe në atë të vlerësimit profesional.

## **GJETJE TË TJERA**

### **93. Lidhur me konfliktin e interesit me personat qiramarrës në pasurinë objekt trekatësh në pronësi të subjektit Hektor Sinanaj**

**93.1** Rezulton se në deklaratën *Vetting* dhe gjatë procesit të rivlerësimit subjekti ka deklaruar se për periudhën nga viti 2000 e në vazhdim ka përfituar të ardhura nga qiradhënia e objektit në Vlorë, në pronësinë e tij. Këto të ardhura subjekti i ka deklaruar si burime financiare për krijimin e pasurive dhe likuiditeteve, si dhe kryerjen e shpenzimeve në vite.

**93.2** Në kuadër të hetimit lidhur me ekzistencën ose jo të konfliktit të interesit, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, duke kërkuar informacion nëse subjekti gjatë ushtrimit të detyrës së gjyqtarit ka gjykuar çështje civile/administrative/penale me palë personat qiramarrës të përmendur prej tij dhe të përmendur në kontrata të thjeshta/noteriale me profesione të ndryshme (biznesmen, topograf, ekspert, avokat ose studio ligjore etj.), si palë ndërgjyqëse/dhe ose përfaqësues ligjorë të palëve në procese gjyqësore apo të pandehur dhe/ose të kallëzuar, për periudhën që ata kanë qenë/janë qiramarrës në objektin në pronësinë e tij. Kjo kërkesë iu drejtua njëkohësisht edhe subjektit të rivlerësimit.

**93.3** Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në përgjigje të shkresës së Komisionit, ka përcjellë<sup>78</sup> kopje të vendimeve gjyqësore, ku avokatë të ndryshëm, qiramarrës në objektin e subjektit, ishin në statusin e sipërpërmendur.

**93.4** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka dhënë shpjegimet<sup>79</sup>: *“Personat apo subjektet e listuara nga ana juaj kanë qenë përfaqësues të palëve në gjykim, në cilësinë e avokatit apo ekspertit topograf<sup>80</sup>”*. Subjekti shpjegon më tej se: *“Nga përmbajtja e vendimeve të mësipërme dhe dispozitivi vendimit, dhënë nga ana ime si gjyqtar, konstatohet se këta avokatë në 70% të çështjeve nuk kanë fituar gjyqet, çka tregon se nuk kanë pasur ndonjë favorizim për arsyen se kanë qenë qiramarrës në kontratën ku bashkëshortja ime është qiradhënëse. Avokatë të tjerë që janë kundërshtarë me ta në këto gjykime dhe që nuk janë me zyra në ambientin e administruar nga bashkëshortja, kanë fituar këto gjykime. Këto çështje me këta avokatë (qiramarrës), në numrin e përgjithshëm të çështjeve që unë kam gjykuar në vitet 2000 – 2023, nuk kapin as 1% të çështjeve, evidentuar sipas statistikave rreth 20.000 çështje të gjykuara nga ana ime 800 – 1,000 çështje në vit. Në Dhomën e Avokatisë Vlorë janë të regjistruar 300 avokatë. Shumë avokatë vijnë nga rrethet e tjera... raportet e mia me këto subjekte avokatë kanë qenë njësoj si me çdo avokat tjetër që edhe ata e kanë zyrën afër gjykatës, baraslarguar. Nuk kanë pasur favorizim për shkak të qenies me kontratë qiradhënie me bashkëshorten time, ashtu si avokatët e tjerë, për shkak se godina ku ata kanë ushtruar aktivitetin ndodhet rreth 150 metra afër gjykatës, janë afëruar dhe kanë zgjedhur këto ambiente si të përshtatshme për të ushtruar aktivitetin. Nga ana ime, duke qenë bashkëpronar me bashkëshorten, u është bërë e qartë se raportet do i kenë vetëm si qiramarrës dhe bashkëshortja ime qiradhënëse. Ndërkohë,*

<sup>78</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2023.

<sup>79</sup> Datë 4.7.2023.

<sup>80</sup> Bashkëlidhur kopje të vendimeve ku ata kanë marrë pjesë në gjykime.

*me mua personalisht nuk do të kenë asnjë raport, komunikim dhe asnjë kontakt për shkak të kësaj çështjeje. Nga ana ime i është dhënë e drejta bashkëshortes për të administruar pasurinë dhe kur më ka vënë në dijeni që kanë kërkuar të marrin zyrat me qira nga disa avokatë. Kam deklaruar çdo vit në ILDKPKI deklaratën e pasurisë. Duke u konsultuar me ligjin, nuk kam gjetur pengesë ligjore dhe konflikt interesi... Së pari, kontrata e qiradhënies nuk është një marrëdhënie biznesi, por një marrëdhënie juridiko-civile që nuk kërkon angazhim aktiv të bashkëshortes së gjyqtarit (që në rastin konkret merret me administrimin e pasurisë), por thjesht administrohet pagesa në rolin e qiradhënësit. ...Së dyti, një i përfaqësuar nga një avokat qiramarrës tek kjo njësi, në një çështje me gjyqtarin, nuk mund të ketë shkaqe të arsyeshme për të besuar se gjykata do të ketë njëanshmëri...çmimit të kontratës në fjalë. Së treti, pagesat e qirave janë të vlerësueshme të ngjashme me ambiente të tjera që jepen me qira në atë zonë dhe nuk ka asnjë tendencë të vendosen çmime preferenciale... Ky lloj aktiviteti i dhënies së ambienteve me qira ka ekzistuar që më përpara kohës së emërimit tim si gjyqtar, kur ushtraja profesionin e avokatit dhe ka histori të gjatë dhe konstante që nuk na ka sjellë deri tani asnjë situatë problematike ligjore apo paragjykimi të figurës së zyrtarit. Si konkluzion, në testin objektiv për paanshmërinë e gjykatës, këto rrethana, në një mendim të arsyeshëm të një vëzhguesi të tretë, nuk mund të jenë të nivelit të atillë që nuk kalojnë testin e jurisprudencës së GJEDNJ-së. Njësia që ekzistojnë ambientet me qira nuk mund të quhet se është në posedim të faktit të gjyqtarit, për sa kohë asnjë ambient në atë njësi nuk është përdorur si ambient i tij personal për asnjë lloj funksioni, si për banim apo si zyrë. Nga ana e palës qiradhënëse – bashkëshortes, në administrim paguheshin energji elektrike dhe uji (ka një sahat matës për të gjithë godinën), ndërsa qiradhënësit kanë paguar sipas ligjit taksën e të ardhurave nga qiraja në burim. Kjo ka qenë e favorshme për ta, prandaj kanë marrë zyrat dhe jo për të përfituar nga unë si gjyqtar. Unë kam qenë gjyqtar që kam pasur sigurinë ekonomike të familjes, e influencuar nga kjo edhe në besueshmërinë si gjyqtar”.*

## **Hetimi i Komisionit**

**93.5** Nga hetimi rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit Hektor Sinanaj përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës së gjyqtarit rezulton se ka gjykuar për afërsisht mbi 180 çështje të natyrave të ndryshme gjyqësore (civile/penale etj...), ku përfaqësues të palëve ndërgjyqëse të kenë qenë kryesisht avokatë dhe ekspertë, të cilët kanë marrë ambiente me qira në godinën 3-katëshe (regjistruar karabina), në pronësi të subjektit Hektor Sinanaj.

**93.6** Kontratat e qirasë deri në vitin 2006 rezultojnë të jenë lidhur ndërmjet avokatëve dhe subjektit të rivlerësimit Hektor Sinanaj dhe më vonë, pas vitit 2007 e në vijim, rezultojnë të jenë lidhur nga personi i lidhur bashkëshortja e subjektit, znj. L.S, në cilësinë e qiramarrëses. Fillimisht, këto kontrata kanë qenë të thjeshta dhe jo të lidhura para noterit publik. Pas vitit 2015 e në vijim, kontratat e qirave janë të lidhura para noterit publik. Të ardhurat nga qiratë subjekti i ka deklaruar për çdo vit si të ardhura vjetore familjare në deklaram.

**93.7** Për të vlerësuar nëse subjekti ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit, Komisioni mori në konsideratë përcaktimet që ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” bën për konfliktin e interesit. Sipas pikës 4 të nenit 3 të këtij ligji: “a) “Konflikt faktik i interesit” është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisive të tij zyrtare; b) “Konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë

ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë; c) “Konflikt i mundshëm i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara”. Në nenin 5 të këtij ligji përcaktohet se: “1. Interesat privatë të zyrtarit janë ato interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdolloj natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; ... 4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdolloj interesi privat i një zyrtari nga ata të përcaktuar në këtë nen, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të këtij ligji. Sipas ligjit nr. 9049/2005, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si subjekti edhe bashkëshortja, si person i lidhur, kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe interesave privatë në ILDKPKI.

**93.8** Në ligjet organike parashikohen rastet e përjashtimit të gjyqtarit. Përkatësisht, në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, pika 6 parashikohet: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”.

**93.9** Në nenin 17, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale parashikohet: “Ekzistenca e marrëdhënieve kontraktuale me palët në procedim përcaktohet si shkak ligjor për heqjen dorë në shkronjën a) të nenit 17, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: “1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit, bashkëjetuesit ose i fëmijëve të tij”.

**93.10** Në nenin 3, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është parashikuar se sjellja e magjistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes e forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magjistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien e drejtësisë në shoqëri, ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike. Në rastin konkret, marrëdhënia e kontratave të qirasë është një marrëdhënie që lidhet direkt me interesin privat, përfitimi i të ardhurave nga qiraja.

**93.11** Për shkak të kësaj marrëdhënieje juridike me qiramarrësit, gjyqtari ka pasur pengesa ligjore të vendosura nga ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, neni 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, neni 17, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”<sup>81</sup>, që synojnë të rregullojnë marrëdhënie të caktuara mes palëve në procese gjyqësore, marrëdhënie midis të cilave mund të ngrenë dyshime për respektimin ose jo të parimit të paanësisë dhe/ose të objektivitetit.

**93.12** Gjendja e konfliktit të interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të

<sup>81</sup> Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.



tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

**93.13** Në vlerësim të pengesave ligjore të përcaktuara nuk është e nevojshme të provohet nëse veprimi apo pasoja ka ardhur, por mjafton vetëm “mundësia” e veprimit kundër parimit të paanësisë dhe të objektivitetit për të vënë në lëvizje detyrimin dhe pasojën juridike të moszbatimit të tij.

**93.14** Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në konflikt interesi, pasi gjendja në të cilën ndodhet për shkak të marrëdhënies me qiramarrësit duket se ka krijuar dhe krijon aktualisht konflikt interesi në vite, gjatë vendimmarrjeve të tij gjyqësore në ushtrim të detyrës së gjyqtarit.

**93.15** Këto rrethana marrin rëndësi edhe për faktin se subjekti ka qenë dhe është gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për një periudhë të gjatë kohe (2000 e vazhdim) dhe kjo lloj marrëdhënie me qiramarrësit duket se e ka ekspozuar atë posaçërisht në cenimin e besimit të publikut, në kushtet kur duhet të kujdesej që sjellja e tij të ishte e denjë dhe të mos ngriheshin perceptime favorizimi apo përfitime për shkak të pozicionit, në sytë e publikut.

**93.16** Sjellja e gjyqtarëve në kontekstin profesional është shumë e rëndësishme. Vlerësohet se ka rëndësi se çfarë veprimesh ka bërë një gjyqtar në përmbushje të detyrës së tij, duke filluar pikësëpari nga respektimi dhe zbatimi me rigorozitet i ligjit, i rregullave procedurale, të cilat janë të qarta mbi lëndën që rregullon. Zbatimi i tyre nuk është një akt i vullnetshëm dhe i pavarur i magjistratit që zgjedhë t’i respektojë ato, por është detyrim ligjor për magjistratin, i cili ka detyrë funksionale të tij dhënien e drejtësisë, e cila duhet edhe të perceptohet si e tillë nga publiku.

**93.17** Gjithkush gëzon një lloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme. *“Çdo njeri ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e ngritur më parë me ligj...”* (neni 47, paragrafi 2 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian).

**93.18** Sa më sipër, nisur nga fakti se ka gjykuar një numër të madh çështjesh gjyqësore, mbi 180 raste në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak të marrëdhënies së kontratave të qirasë lidhur me një numër avokatësh dhe ekspertësh, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**93.19** Gjatë prapësimeve subjekti, ndër të tjera, është shprehur se u qëndron të njëjtave pretendime që ka paraqitur edhe në drejtim të kësaj problematike të ngritur nga Komisioni. Sipas subjektit, nuk ka parashikime ligjore për qenien në situatë konflikti të interesit mes zyrtarit dhe qiramarrësit. Marrëdhënie të tilla janë objekt interpretimi në mënyrë të zgjeruar të legjislacionit për parandalimin e konfliktit të interesit. Sipas tij, asnjë organ kompetent nuk e ka pretenduar qenien në situatën e konfliktit të interesit, as ILDKPKI-ja, as KLGJ-ja dhe gjykatat e nivelit më të lartë, në mënyrë që të shprehnin një qëndrim në lidhje me këtë situatë. Pretendimi për situatën e konfliktit të interesit citohet vetëm në raportin e Komisionit dhe në fillimin e procedimit të iniciuar nga ILD-ja. Subjekti shprehet gjithashtu se sapo ka marrë dijeni për rezultatin e Komisionit dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë se një situatë e tillë mund të klasifikohet në qenie të mundshme në konflikt interesi, ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimet ku

palë ishin qiramarrës në ambientet me qira, duke shmangur çdo paragjykim situatë të mundshme të konfliktit të interesit.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**93.20** Në analizë të kuadrit ligjor dhe të të gjitha provave të administruara, rezultoi e provuar se subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

**93.21** Në përfundim, Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat në përgjigje të barrës së provës – arsyetoi se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e tij të gjyqtarit në kushtet e konfliktit të interesit.

**94. Në përfundim**, trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të rivlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Hektor Sinanaj, nuk është “i aftë”, pasi ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim jo të drejtë, nuk ka respektuar të drejtat e palëve, nuk është eficient, si dhe ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Hektor Sinanaj, ka plotësuar së bashku kushtet si vijon:

- a. nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. nuk ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
- d. Nisur nga sa më sipër, lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues vlerëson se duke marrë në konsideratë problematikën lidhur me kriterin e pasurisë, si dhe mangësitë e evidentuara në vlerësimin e aftësisë profesionale dhe denoncimet nga publiku, si më lart janë arsyetuar, subjekti i rivlerësimit ka cenuar me sjelljen e tij besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. për pasojë, ato çmohen në zbatim të nenit 61, pika 5 dhe pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Hektor Sinanaj, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Vendimi u shpall në Tiranë, në datën 13.3.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila PINE**  
**Kryesuese**

**Alma FASKAJ**  
**Relatore**

**Pamela QIRKO**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Albana Plaka*